

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 217, Nëntor 2021

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Në ZYM të HASIT

NË 50-VJETORIN "TAKIMET E GJEÇOVIT-2021"

2

Kush është Zymi i Hasit? Zymi i Hasit gjendet në mesin e Hasit dhe konsiderohet si qendra e Hasit të Kosovës. Etimologjia e emrit të vendit Zymit rrjedhë nga gjuha latine "Sumbi", që në gjuhën shqipe do të thotë "Përhimët", diçka që i përgjanë ngjyrës së Gurit. Zymi i ashtuquajtur edhe Zyza, njihet edhe si nga një vendbanim dardan i periudhës së hekurit, që në mes të fshatrave Ramaja të rajonit të Hasit e të Vlashnjës (në afërsi të Zhurit) të rajonit të Lumës, që megjithatë ato konsiderohen vendbanime të afërta me Zymit e sotëm.

Zymi përbëhet nga shtatë lagje (Voshi, Çollaku, Kërhani, Lumezi, Prekpalë, Berisha dhe Tomëreci), që shtrihet në shtatë kodrina, ndryshe njihet edhe si Roma e Vogël, pasi që edhe Roma e Italisë shtrihet në shtatë kodrina (Palati, Avetin, Kapilotin, Keliusin, Viminalin, Eskvilin dhe Janikulin), që simbolizojnë shtatë mrekullitë e botës.


Fshati Zym i Hasit të Kosovës është i vendosur në shtatë kodra si qyteti i famshëm i Romës mund të numërojë shtatë mrekullitë e veta kulturore:

Së pari, përmenden zymjanët në Betejën e Kosovës qysh në vitin 1389;

Së dyti, një ndër hipotezat mbi origjinën e Gjergj Kastriotit thotë se ai ishte nga Hasi i Thatë;

Së treti, nga Zymi ishin mirëfilli Pal Hasi dhe dinastia Bogdani (Ndre, Pjetër, Gjon e Lukë Bogdani);

Së katërti, aty kanë shërbyer Mëhill Suma, Lazër Lumezi, Ndue Bytyçi, Pjetër Mazrreku dhe ndër më të shquarit, Iqeshkvi dhe shkrimtari nga Gjakova, Gjon Nikollë Kazazi, që kishte zbuluar në Romë "Mesharin" e Buzukut; ...



LEC SHLLAKU ARKITEKTI I TEATRIT PROFESIONAL SHKODRANË DHE ELBASANAS, NË DATËLINDJEN e 100-të


Sot do ishte rrumbullak 100 vjeç fort iu afrua, por nuk e gëzoi këtë datëlindje, që ëndërron çdo frymore me ndërjegje. Ky kapak shekullare i fillim i vjeshtës së tretë nuk e gjeti këtu. Ai vetëm fizikisht mungon mbasi në kujtesë tonë mbetet si bazile vetmitare. Trembëdhjetë mote kaluan që trupi i Kolec (Lec) Shllakut pushon në hijen e selive nder Rmaj, në atë tokë të mbjellë me eshtrat e të shumëve të jetit të shumë kënduar veriperëndim.

11

NË GJURMËT E PREND BUZHALËS NJË PROFIL I BEGATË DHE CILËSOR JETËSHKRIMI E VEPRIMTARIE

- Me rastin e 70-vjetorit të lindjes së shkrimtarit e Anëtarit të Nderit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" -


15



Marash Tuci, në bibliotekën "Marin Barleti"

Me datën 7 nëntor 2021, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", në bashkëpunim me Shoqatën "Lidhja e shkrimtareve e artisteve Shkodër" dhe Shoqatën Atdhetare "Malësia", në mjediset e bibliotekës "Marin Barleti" organizojë e zhvillojë ceremoninë e promovimit të librit, me titull "Marash Tuci, ndorja shqiptare"-novelë, me autor shkrimtarin, poetin, historianin, publicistin, botuesin e N/kryetarin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Prele Milani, një vepër e veçantë për nga përmasat e zhvillimit të ngjarjeve, që në qendër të këtij libri, të kësaj novele, është BESA, për të cilën shquhen në veçanti malësorët e në tërësi shqiptaria. Krenet e Nikaj-Merturit thirren e priten nga Veziri i Shkodrës, por priten në besë dhe Marash Tuci, jep jetën në mbrojtje të tyre, se i kishte marrë në ndorje. Kjo veprimtari u drejtua me kompe-tence nga gazetaria e TV1-Channel, zonja Lindita Kavaja.

4



Në ZYM të HASIT

NË 50-VJETORIN “TAKIMET E GJEÇOVIT-2021”

Kush është Zymi i Hasit?

Zymi i Hasit gjendet në mesin e Hasit dhe konsiderohet si qendra e Hasit të Kosovës. Etimologjia e emrit të vendit Zymit rrjedhë nga gjuha latine “Sumbi”, që në gjuhën shqipe do të thotë “Përhimët”, diçka që i përgjanë ngjyrës së Gurit. Zymi i ashtuquajtur edhe Zyma, njihet edhe si nga një vendbanim dardan i periudhës së hekurit, që në mes të fshatrave Ramaja të rajonit të Hasit e të Vlashnjës (në afërsi të Zhurit) të rajonit të Lumës, që megjithatë ato konsiderohen vendbanime të afërta me Zymit e sotëm.

Zymi përbëhet nga shtatë lagje (Voshi, Çollaku, Kërhani, Lumezi, Prekpali, Berisha dhe Tomëreci), që shtrihet në shtatë kodrina, ndryshe njihet edhe si Roma e Vogël, pasi që edhe Roma e Italisë shtrihet në shtatë kodrina (Palati, Avetin, Kapilotin, Keliusin, Viminalin, Eskvilin dhe Janikulin), që simbolizojnë shtatë mrekullitë e botës.

Fshati Zym i Hasit të Kosovës është i vendosur në shtatë kodra si qyteti i famshëm i Romës mund të numërojë shtatë mrekullitë e veta kulturore:

Së pari, përmenden zymjanët në Betejën e Kosovës qysh në vitin 1389;

Së dyti, një ndër hipotezat mbi origjinën e Gjergj Kastriotit thotë se ai ishte nga Hasi i Thatë;

Së treti, nga Zymi ishin mirëfilli Pal Hasi dhe dinastia Bogdani (Ndre, Pjetër, Gjon e Lukë Bogdani);

Së katërti, aty kanë shërbyer Mëhill Suma, Lazër Lumezi, Ndue Bytyçi, Pjetër Mazrreku dhe ndër më të shquarit, Ipeshkvi dhe shkrimtari nga Gjakova, Gjon Nikollë Kazazi, që kishte zbuluar në Romë “Mesharin” e Buzukut;

Së pesti, në Zym të Hasit ka qenë strehuar Ipeshkiva Shkup-Prizren (1702-1725), kohë kur ajo u përfaqësua në Kuvendin e Arbërit (Mërqi, 1703) nga ipeshkvi Pjetër Karagjiqi dhe dy zymjanë;

Së gjashti, Gjeçovi i Kanunit të Lekë Dukagjinit;

Së shtati, “Abetarja e Zymit”. Kjo e fundit është si një fill vazhdimësie që unifikon kohërat dhe mrekullitë e Zymit.

Kur shfletojmë hartat e shkollave shqipe në trojet etnike shqiptare dhe historinë e letërsisë, ndër shkrimet e vjetra, padyshim se do të gjejmë edhe shkollën e Zymit. Hasi në përgjithësi e Zymi në veçanti, në çdo periudhë kohore ka krijuar një botë e një histori në vete, që ka mbajtur gjallë vetëdijen kombëtare e fetare si për punë edhe për veprimtari edukativo-arsimorë, në këtë mes duke krijuar një “oazë” specifike më vete.

Rruga e shkollës së Zymit është një odisë, duke formuar një përmendore edukative-arsimorë, arsimtarët kanë punuar nëpër shumë shtëpi – shkolla dhe kanë formuar kullën apo përmendoren e shkollës së ditërisë, ku skaliten emrat e tyre me një histori të begatëshme.

Fundi i shekullit XIX dhe XX, do të karakterizohet nga përpjekjet e patriotëve shqiptarë për lëvizimin e gjuhës shqipe. Në rrethanat e sundimit osman kjo abetare ka vlerë, si njëra ndër abetaret e para në Kosovë. Në këtë periudhë ishte e domosdoshme, hartimi i ndonjë teksti mësimor, e në radhë të parë abetareve, kur popujt e



tjerë të Ballkanit këtë problem e kishin më të zgjidhur kohë më parë, si grekët, rumunët, bullgarët. Ky evoluim erdhi me Naum Veqilharxhin, duke e botuar në vitin 1844 abetarën e cila u quajtë “Evetar”, që luajti një rol të rëndësishëm për mësim e gjuhës shqipe dhe u vijua me abetare të tjera të hartuara nga Konstandin Kristofordhi, Daut Borçi, Shoqëria e Stambollit, në këto rrethana kulturore u botua edhe Abetarja e Zymit, e cila është gjetur në Prizren me 20 maj 1900.

Guri i lapidarit me mbishkrimin e “Abetarës së Zymit” u zbulua më 10 tetor 2007, që vet guri është një shkëmb shpatull

– gjërë, me vija të lakuara e të kthyer, por i lidhur mirë si nyje. Kjo pamje tregon peripecitë historike shumë shekullore, rrugën e gjatë dhe zigzake, çdo vragë tregon trysnitë e pushtueseve me simbole e shenja dalluese shumë karakteristike vertikale dhe horizontale të kohës. Njëherit, Guri Lapidar–stelë simbolizon relievin e vendit qëndrueshmërinë, pavdekësinë, kullën e vjetër prej gurit ku është mbajtur mësimi, forcën madhore, jetën në Gurin e Thatë të Hasit, betimin në gur, besën e pakthyeshme të popullit vendas, andaj edhe u kushtohet njerëzve të shenjt që bëjnë vepra pashtu të shenjta siç e botuan “Abetarën e

Zymit”. Edhe “guri” ka fuqinë e një shenjti, pranë tij liheshin përkushtime (nezra). Njeriu në rrugë, pranë ndonjë “Guri të Shejtë” lënte “amanetin”, duke ia vënë mbi te një gur të vogël nga se nuk guxonte kush për ta prekur (marrë). Por, ka edhe attribute, si: Guri i Kufirit (mezhdës), Guri i Besës, Guri i Pendesës, i sullit (vendimit) dhe thuhet Shtëpi-Guri, Fjalë-Burri.

I tërë Zymi i Hasit, me datën 30 tetor 2021, ishte në një festë po të thuash kombëtare, se në këtë festë morën pjese nga të gjitha trevat shqipfolëse; po shënohej 50-vjetori i Takimeve të Gjeçovit.



Fillimisht, u vu gurthemeli për monumentin “Nëna e Zymit”.

Merrnin pjesë krijues letrarë, njerëz të kulturës nga Kosova, Shqipëria, diaspora e viset tjera, por edhe përfaqësues të jetës shoqërore e politike. Kështu, këtë manifestim e përshëndeti kryeministri i qeverisë së republikës së Kosovës, Albin Kurti, Gjeneral Dedë Prenga-këshilltar i Presidentit të Shqipërisë Ilir Meta, Vehbi Miftari-këshilltari e Presidencës së Republikës së Kosovës, zonjës Vjosa Osmani dhe të tjerë. Kurse për këtë jubile të rëndësishëm foli kryesuesi i këtij manifestimi At’ Ndue Kajtazi.

Viteve të fundit, në amfiteatrin e Zymit, përgjatë gjithë skenës, hapet edhe ndonjë ekspozitë me vlera të rëndësishme të traditës sonë. Kësaj radhe kjo ekspozitë ishte e Luan Çoçajit, me ekspozate etnografike e nga fushat e arkeologjisë, kryesisht punime nga fusha e bujqësisë, por edhe e jetesës së shqiptarëve në kohët e kaluara.

Një përshëndetje, për veprimtarinë e Frrok Kristaj, që e ka organizuar këto takime për 50 vjet rresht, e lexoi Liridona Shehu.

U ndanë edhe çmimet tradicionale të manifestimeve nga fushat e studimeve të traditës dhe të letërsisë, si dhe një varg mirënjohjesh për kontribuuesit zymjanë të këtij manifestimi e për kontributet në lëmenjtë tjerë të kulturës.

Mandej, në Orën tradicionale letrare, lexuan poetët: Agim Gjakova, Hysen Graçevci, Skënder Zogaj, Martin Çuni, Osman Grabovci, Rabije Bytyqi, Prend Buzhala e të tjerë.

Në këtë takim Shoqata Atdhetare “Dukagjini” përfaqësohej nga kryetari i saj, Ndue Sanaj, studiuesi i gjuhës shqipe, përkthyesit dhe presidenti i shtypshkronjës “FIORONTINA”, Maritan Spahija dhe poeti Lulash Brigja.

Në këtë manifestim, në emër të Shoqatës dhe grupit pjesëmarrës përshëndeti Ndue Sanaj, që në mes të tjerave theksoi: “Kënaqësi e veçante, që marre pjesë në këtë përvjetor të klubit letrar, kulturor e shkencor, i pagëzuar me emrin “Takimet e Gjeçovit” dhe në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” t’u përshëndes e urime në pesëdhjetëvjetorin e themelimit të këtij klubit. Gjithashtu, në emër të grupit pjesëmarrës, t’u them “Mirëse ju gjetëm”.

Jeta dhe vepra e at Shtjefen Gjeçovit është e njohur kudo në Shkodër, në Shqipëri dhe në Kosovë. Ndihehi të vlerësoar dhe krenar, që jemi pjesë e kësaj veprimtarie jubilarë në nderim të tij.



Ndue Sanaj, duke i dorëzuar titullim “Mirënjohja Martin Camaj”, kryetarit të “Takimeve të Gjeçovit” dr. Frrok Kristaj



Aktori Ismet Krasniqi e shkrimtari Prend Buzhala, duke i dorëzuar poetit Lulash Brigja titullin “Mirënjohja”



Mark Palnikaj, Ndue Sanaj e Meritan Spahija

Emri i këtij klubi, është emri i një nder personalitetet e veçantë që ka dhanë një kontribut të çmuar në shërbim të kombit, të kulturës e jetës së qëndruesës të popullit tonë, At’ Shtjefen Gjeçovi.

Përveç atyre që ju njihni, por në bashkësinë dukagjinase janë pjesë jetës e shpirtit të tyre, At’ Shjefen Gjeçovi e At’ Justin Rrota, se ata janë të paret që hapen shkollën shqipe në Dukagjinin e Shkodrës dhe që u njohën nga shteti shqiptar i kohës: I pari, me 2 shkurt 1917, në fshatin Thethe të krahinës së Shalës dhe me 17 shtatore të këtij viti, në fshatin Prekal; ndërsa i dyti, me 1 dhjetor 1917, në fshatin Plan të krahinës së Pultit.



Për këtë, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në muajin shtator 2017, në kuadrin e 100 vjetorit të hapjes së këtyre shkollave, organizoj e zhvilloj konferencën shkencore, me temë: “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”.

Mirënjohje e Lavdi për jetën e kontributin e tyre në shërbim të kombit Shqiptar!

I nderuari zoti Frrok, me ftesën që na bëri, jo vetëm na vuri para përgjegjësisë për të marre pjesë në këtë ceremoni të 50 vjetorit, por vuri në punë dhe kryesinë e shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, e cila pasi diskutoj për ftesën e bërë, vendosi: Të nderoj Manifestimin tradicional kulturor “TAKIMET E GJEÇOVIT”, me titullin “**Mirënjohja Martin Camaj**”, me motivacion: “Për kontributin Tuaj 50-vjeçar, në ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare mbare shqiptare, për vlerat e larte artistike dhe mesazhin që përcjellë veprimtarinë e klubit tuaj letrar. Në shenjë vlerësimi të jetës dhe veprës të At’ SHTJEFËN GJEÇOVIT”.

Shoqata e kulturës e artist “Katarina Jospipi” e Zymit dha një program me vlerë popullore.

Në këtë manifestim u takuam me katërmosketieret e “Ditës së Plisit Bardhë”, aktorin Ismet Kraniqi, shkrimtarin Prend Buzhala, poetin e piktorin Idriz Berisha e poetin e skulptorin Gjon Gjergjan, me të cilët shkëmbyem mendime mbi mundësitë

e organizimit e zhvillimit të veprimtarive së bashku në vijim dhe u dhamë mbi 30 gazeta “Dukagjini”, për secilin numër, nga muaj qershor e deri në muajin tetor 2021, nr. 216 të saj, për të cilat ndjenë krenari, që ne vijojmë të nxjerrim gazetën dhe na falënderuan. Takuam dr. Mark Palnikaj, Gjeneral Dede Prenga e të tjerë miq të Shoqatës.

Shkrimtari Prend Buzhala na dhuroj librin, me titull “NË AKTIN E LEXIMIT”, të cilin e falënderova shumë, në veçanti se, në këtë libër ishte dhe opinioni i tij, mbi librin tim, me titull “Kujtimet e një ushtaraku”.

Poetin Lulash Brigja, grupi organizator të “Ditës së Plisit” e nderuan me titullin “Mirënjohja”, me motivacion: “Për veprimtarinë e Tij të vyer me shumë identitet, me taban të mirëfilltë Dukagjinase dhe Kombëtar. Për tematikën e pasur nëpërmjet poezisë, por dhe të publicistikës e fotoreporterit, Ai ka eksploruar vlera historike, kulturore etnografike dhe sociale të Trevës ku jeton, por edhe të zonave të tjera në Trojet Shqiptare. Veçmas e falënderojmë për kontributin e dhënë në veprimtaritë e Ditës të Plisit”!

Një takim mjaft mbresëlënës!

Mundësoi pjesëmarrjen tonë anëtari i Kryesisë, Marjan Ndershtiqani, Presidenti i shtypshkronjës “FIORONTINA”, Meritan Spahija dhe Lulash Brigja, të cilët i uroj me shprehjen popullore “Paçin e dhënçin!”

Përgatiti
Ndue Sanaj e Lulash Brigja

Marash Tuci, në bibliotekën “Marin Barleti”

Me datën 7 nëntor 2021, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në bashkëpunim me Shoqatën “Lidhja e shkrimtareve e artisteve Shkodër” dhe Shoqatën Atdhetare “Malësia”, në mjediset e bibliotekës “Marin Barleti” organizoj e zhvilloj ceremoninë e promovimit të librit, me titull “Marash Tuci, ndorja shqiptare”-novelë, me autor shkrimtarin, poetin, historianin, publicistin, botuesin e N/kryetarin e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Prele Milani, një vepër e veçantë për nga përmasat e zhvillimit të ngjarjeve, që në qendër të këtij libri, të kësaj novele, është BESA, për të cilën shquhen në veçanti malësorët e në tërësi shqiptaria. Krenet e Nikaj-Merturit thirren e priten nga Veziri i Shkodrës, por priten në besë dhe Marash Tuci, jep jetën në mbrojtje të tyre, se i kishte marrë në ndorje.

Kjo veprimtari u drejtua me kompetence nga gazetaria e TV1-Channel, zonja Lindita Kavaja.

Në këtë ceremoni morën pjesë shkrimtar, poet, veprimtar, politikane, anëtar të tri shoqatave, dashamir të autorit dhe familjar të tij.

Mori pjesë deputetja e Shkodrës dhe Anëtarja e Nderit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, zonja Gerta Barleti; Konsulli i Nderit të republikës së Austrisë në Shkodër, zoti Gjergj Leqejza; zoti Zija Vukaj, kryetari i shoqatës së shkrimtareve Shkodër; Ilmi Kurti, Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Malësia”; Kryetarja e Shoqatës “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, zonja Rita Shkurta; redaktori i librit, studiuesi i gjuhës e përkthyesi dhe presidenti i shtypshkronjës “Fiorentia” Meritan Spahija; poetja Prenda Sejdia; kritiku Kadri Ujkaj, publicisti Kadri Fikaj, poeti Lazer Kodra; poetja Lifee Hasa; poetja Farida Ramadani, poetja Djana Çelepja –Tabaku; studiuesi e botuesi Voc Deda, grupi folklorik “Besa e Shoshit”,

me kryetarin e tyre, zotin Ndoc Fusha; pasardhësi i familjes së Marash Tucit, Sokol Marashi dhe të tjerë.

Në këtë promovim u dhanë shumë opinione: Poetja Prend Sejdia, recitoj Dorjana Blinishta; Studiuesi e redaktori i librit, Meritan Spahija; Ndue Sanaj; përkthyesi Zija Vukaj; studentja Besarda Shkoza; kritiku Kadri Ujkaj; poetja Mimoza Rexhvelaj; studiuesi Kadri Fikaj; poeti Lazer Kodra; Kryetarja e Shoqatës “Xhubleta e Alpeve e Shqiptare” studiuesja Rita Shkurta; studiuesi Zef Mark Zeka; Ilmi Kurti; studiuesi e shkrimtari Ali Daci nga Rrozhaja; pastaj mori fjalën grupi “Besa Shoshi” duke kënduar këngën me

çifteli, për Marash Tucin.

Në fund e mbylli këtë takim Sokol Marashi, pasardhësi i Marash Tucit, që ftoj pjesëmarrësit për një koktej ...

Poetja Mimoza Rexhvelaj, në mes të tjerave theksoi: “Marash Tuci ndorja shqiptare” asht libri ma i ri i shkrimtari Prel Milani. Me këtë libër Prela ka tejkalua vetvetën, rrëfimi i ngjarjeve nga Shoshi i Dukagjinit vjen ambel plotë ndjenja vëllaznore, plotë dashni për malet hijeranda ku rriten trimat dhe trimneshat, ku besa asht baraz me besimin në të madhin zot. Ku për besë njiri vdes dhe kthye mrapsh, se korit vedin e krejtë krahinën. Duket që Prela ka kenë orëçuet kur ka nis udhëtimin me Marash Tucin e Shoshit, ia ka pri të marën duke sjell krejt Dukagjinin me bukurit e madhështin e tij, me historinë, trimninë, bujarinë, besën që pak kund i gjen skalitur ndër rreshta me mjeshhtëri të madhe siç i gjen tek ky libër që kemi në dorë.

Edhe ma parë autori ka shkruar për këtë trevë me histori të pasun e ngjarje të thana,

jua ka kënduar kangën këtyre burrave e burrneshave, por Prela bani shumë ma shumë, i fali jetën e dytë Marash Tucit, jetën e pavdekësisë mes madhështisë... Suksese Prele Milani!”

Studiuesja Rita Shkurta, në mes të tjerave theksoi: “Novela “Marash Tuci, ndorja shqiptare” e autorit Prel Milani, është padyshim një thesar në fushën e trashëgimisë kulturore. Kjo novelë mund të rënditet pa frikë, një ndër prurjet më të pasura me shprehje të vjetra, si visare të trashëgimisë gojore ndërkrainore, që lidhen kryesisht me veprime të dobishme, me të cilat autori është kujdesur të veshë e pasurojnë me dinjitet anën shpirtërore të malsorëve (personazheve) në bashkëjetesë me njëri - tjetrin dhe me mjedisin natyror ku punojnë e veprojnë prej shekujsh. Gjithashtu përgjatë gjithë librit kjo novelë sa vjen e pasurohet me fjalët e urta si: “Duhani e kuveni shkojnë bashkë si tymi me flakën” apo “Shoshin e ke për shatë e për zanatë”, duke nxitur imagjinatën e lexuesit për tu përfshirë në ngjarje, të cilat edhe pse në formë trillimesh të bëjnë ti përjetosh shpirtërisht. Mjaft bukur

**Poetja Prenda Sejdia, mbajti temën
“Epika e një realiteti në novelë”**

“Qënie që i përshtatet gjithçkaje, është përkufizimi më i mirë që mund t'i bëhet njeriut.

Mendimet e mëdha e kanë burimin jo aq nga mendja e madhe, se sa nga një ndjenjë e madhe.

Pra, arti është një kërkesë për njeriun ashtu si të ngrënë e të pirët”, theksonte Fjodor Dostojevski.

E nis këtë shkrim nga një mendje që ndriçoi me dritën që përhap.

Sepse mendje të tilla ndriçojnë epokë e Penat e stërvitura qëndisin fjalën gërshtuar me bukurinë e shpirtit e si birë i atyre trojeve vazhdon udhëtimin mbi gjurmët e tyre si një zingjirë i pashkëputur i dijes, fisnikërisë, besës e bujarisë, traditës e kulturës.

Erërat e maleve e lisat e moçëm sjellin gjuhë perendie, ku të ngjan se zgjojnë zërat e lashtësisë nga drurë e gurë ku mbars mirësinë njerëzore tek kundron në mënyrë imagjinare fisnikërinë e maleve kreshnike që shtrihen hareshëm në krah të njëri- tjetrit, për t'u stërzgatur deri në pikën më të lartë ku pikon strategjia e moçme që të sotmes i përgjigjet me gjuhën e heshtjes ashtu siç thonë se shkrimtari flet me një fjalë sa një njeri i thjeshtë se thotë as me 1 000.

Historia e atyre maleve e mbërthyer në virtyte e endur në perla që kur ka le germëzojnë frymëmarrjen e shpirtërave të paepur dhe profecitë lartësohen për etërit fisnik.

Autori i librit Prel Milani më së miri vjen në këtë gjini epike me këtë rrëfim përmes personazheve në këtë lloj (prozë) pra një novelë me vlera të theksuara letrare ku rrëfen me

vetdije dhe respekt plagët e shqiptarit në tërësi por konkretisht plagët e malësorit trim e besnik me stilin e zhdërvjellët e ndjeshmërinë e lartë të qytetarisë e përmes artit rrëfen madhështinë e atyre njerëzve që udhëhiqen nga morali, besa e parimet e larta njerëzore.

Zotërimi i gjuhës dialektike e disiplina e tekstit dëshmojnë një pjekuri e përgjegjësi si e ardhme e letërsisë shqipe.

Me ndjeshmëri e ndijim harmonik në ndërtimin e një rrëfimi modern.

Rrugëtimi i novelistit në përmbledhjen e plotë të prozës me ngjarje të vërtetë të epikës deri në destinacionin e novelës është dëshmi e mendimit të kulluar të



e të pathana, por kësaj herë nuk vjen veç historia e një djali të ri nga dera fisnike, nuk vjen veç tragjizmi e fati i trishtë, por ambël e bukur përshkruhet dhe dashnia mes dy të rinjve. Marashi e Rudina që nuk e kurorëzuan me martesë dashnin e madhe të tyne, por nga pena e Prelës ata u skalitën në memorjen e lexuesit në perjetësi. Sot Prela jua bani dasmën e madhe me gjithë krahinat e parin e Shkodrës në Bibliotekën “Marin Barleti” ku pata fatin me qënë me krushqit. Marash Tuci heroi i heshtun deri sot, pak e aspak njohur nga brezat e rinj, ju shtua yjeve që shnisin qiellin e shqiptarisë për me u ba i pavdekshëm ndër trojet tona. Populli jonë ndër shekuj

autori ka cekur toponimet dhe emertimet e moçme që gjithnje e më shumë po humbasin përdorimin dhe kuptimin. Pena e hollë e autorit Prel Milani me një gjetje tejet të arrirë cek edhe edukimin e brezave në vijimësinë e jetës: “Marash për 50 vjet ja punuem lugun mullinit. Unë kam me kenë te t’shumtit, por ti me ndonjë djalë të ri ke me nxjerr tjetrin”. Këto e shumë ngjarje të jetume do jenë padyshim kënaqësi për lexuesin, të cilat edhe do ti mbaj mend gjatë, ndaj e përgëzoj autorin për guximin e suksesshëm nga i cili lexuesi do dijë edhe ta vlersojë maksimalisht.

BESA në librin “Marash Tuci - ndorja shqiptare”

Kënaqësi e veçantë të shpreh disa mendime të mia, por dhe në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me rastin e paraqitjes të këtij libri, me titull “Marash Tuci, ndorja shqiptare”, novele, të autorit të njohur tashme, zotin Prele Milani.

Pse dhe në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”?


Shoqata është themeluar 18-19 vjet më parë, kur Prele na u prezantua me librin, me titull “Bibla në vargje”, duke vijuar në shembullin e shkrimtarit e përkthyesit Lazer Stani, filloi jo vetëm seria e botimeve të Preles, por duke u ndjekur dhe nga shokë e anëtar të tjerë të Shoqatës, si Luigj Shyti, Lazer Kodra, Voc Deda, profesor Zef Gjeta, profesor dr. Vuksan Kola, Lulash Brigja, Ndue Sanaj, Pjeter Gera, Prele e Mri Kroj, Zef Lulash Sokoli e Lulash Ndoc Gilaj e të tjerë. Ky libër që paraqitet sot është i 73-ti, që janë botuar nga personat e mësipërm promovua ose jo. Kjo tregon, se Shoqata, pa organizuar një konferencë të veçante apo bërë një thirrje të veçante, anëtarët e saj, u nxitën nga brezi i paraardhësve të tyre dukagjinasi, si piktori Ndoc Martin Camaj, At’ Banartin Palaj, At’ Daniel Gjeçaj, albanologu Martin Camaj, Ernest Koliqi e të tjerë e të tjerë, se në çdo kohë ka të rejat e veta dhe që duhen lenë të shkruara, duke u larguar nga gojëdhënat, se edhe pse ato kanë vlerat e veta, por duke kaluar brezat, një brez shton diçka e një brez heq diçka dhe është e vështirë të vije e vërteta e plote deri tek brezi tjetër, deri te ne. Ajo, që shkruhet, mbetet e pavdekshme mbi të cilën brezi ecën më tej apo dhe bën ndryshime sipas informacionit që merret nëpërmjet zbulimeve të reja. Por e rëndësishme është se hidhet një baze, që deri më sot nuk e kishim. E theksoj këtë, se ky tregues është një nder arritjet më të mëdha të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Me këtë novele, me titull “Marash Tuci, ndorja shqiptare”, Prele Milani, sikur i përgjigjet Nonda Bulkes, i cili gati një shekull më parë theksonte: “Ç’i ka dhënë kjo rracë botës? Kordhëtar, artiste, dijetarë, pashallarë, pape, perandorë ... Do të shkruhet vallë ndonjëherë ai libër ku të thuhet se ç’i ka dhënë ky fis botës gjate shekujve? Ky do të jete libri i artë i popullit shqiptar!” Nonda ndalet te vlerat e personalitetëve të veçanta kombëtare, por dhe këtu kemi aktin më të lartë, që tregon BESËN e malësorit dhe që për ne është e madhe, por është dhe kombëtare, sepse Besa u mbajt duke sakrifikuar jetën si me le, për kundër një pushtuesi prej shekujve me radhe, siç ishte ai osman.

Pra akti heroik i krerëve të Nikaj-Merturit dhe i djalosht dukagjinasi, nga fshati Brashte i krahinës së Shoshit, është një akt i veçantë heroik, sepse Marashi jo vetëm do

të tregonte formimin e tij, me tradita të theksuara atdhetare, me besën, me bujarinë, me gjithçka kërkonte koha për një djalë malësor. Dhe jo vetëm kaq, por dhe njohës të mirë të historisë, sigurisht sipas gojëdhënave, por ashtu siç ishte transmetuar brez pas brezi dhe e thënë me mjaft

shkruar apo e folur, është shembulli ai që udhëheq. Mund të vihet në dyshim çiltërsia e fjalës, por s’ka se si të mos besohet shembulli i dhënë. Fjala është e diskutueshme, shembulli flet vetë!” Pra, ne mund të flasim e flasim, shkruajmë e shkruajmë për virtytet malësore, por mund dhe të



saktësi e siguri nga djaloshi shoshjane.

Këta trima, ky djalosh, nëpërmjet shkrimit të Preles, me atë fjalor krahinor e thotë mjaft mirë, atë që ne jo në pak raste e nënvleftësojmë: “Më shumë se sa fjala e

mos bisedohen, por akti i kryer, shembulli i këtyre burrave dhe në veçanti i këtij djaloshi flete vete dhe nuk ka nevojë për komente.

Në kohën e Aleksandërit të Madh, në

beteja luftëtarët ecnin me guxim drejt kundërshtarit deri në sakrifikim të jetës së tyre pa e bere mëdyshje, se e dinin, që Mbreti i tyre, Aleksandri ishte në vijën e parë të frontit. Pra, ai drejtonte, udhëhiqte me shembullin e tij. Shembulli flet vete!

Prela, përveç këtyre dy aneve mjaft përcaktuese për jetën e malësorit dhe që njihet shqiptari e në veçanti malësori për besën, për bujarinë, për zgjuarsinë natyrale e të tjera, na shkruan dhe për ndjenjën më njerëzore, dashurinë, për krijimin e familjes. Pra, malësori dashuronte, pavarësisht se kushtet e vështira të jetës nuk i jepni mundësi ti shërbenin dashurisë. Këtu mjaft bukur, me një fjalor të bukur krahinor përshkruan dashurinë në mes Marashit e Rudinës, që fatkeqësisht mbyllet me vrasjen e Marashit dhe që Rudina merre vendimin e paparashikuar, që ajo t’ia mbaj besën e dhënë përjetë të jetës Marashit dhe heq dore nga martesë me ndonjë tjetër djalë. Dhe ky vendim i Rudinës është po aq heroik sa dhe i Marashit, bashkëshortit të saj të ardhshëm, në përjetësi.


Për këto përshkrime Prele ka treguar here pas here aftësitë tij si shkrimtar.

Prela me redaktorin e librit, të nderuarin Maritan Spahija, studiuesi i gjuhës, përkthyesi e presidenti i shtypshkronjës “Fiorentia”, kanë bërë një punë të veçantë, duke shpjeguar disa fjalë, që janë përdorur nga banoret e Dukagjinit në shekuj dhe që Prele ka bërë gjitha përpjekjet të shkruaj me atë fjalor, që në të njëjtën kohë tregon formimin e Preles në punën e tij si shkrimtar.

Prela nëpërmjet kësaj novele, na thotë, se duhet të dimë të lexojmë dhe se nuk është e lehtë të mësojmë të lexojmë. Për këtë, Gete theksonte: “Njerëzit e rëndomtë dine pak se sa kohe dhe ç’përpjekje i duhen njeriut për të mësuar leximin. Kam tetëdhjetë vjet që lexoj dhe ende nuk e mësova ...”. Prandaj, në veçanti brezi i ri, duhet të lexojnë e të lexojnë, se vetëm duke lexuar njihet e mësohet në tërësi, mësohet historia e jonë, jeta e jonë dhe mund të nxjerrim mësim prej saj e të ecim përpara.

Duke e mbyllur, falënderoj zotin Prele për punën e bërë, që nëpërmjet kësaj novele na pruri në kohën tonë të gjalla virtytet e paraardhësve tanë, që jo vetëm ne, por në veçanti brezi i ri, të njihet e ta ndjeje veten krenar për prejardhjen e tyre.

Ju uroj të bëni punë të palodhur në fushën e studimit e krijimtarisë suaj në shërbim jo thjeshtë të Dukagjinit e dukagjinasi, por dhe të kombit tonë, me ndihmesën tende po aq të palodhur, bashkëshorten, zonjën Angelina, se nuk mund të jeni kaq i suksesshëm pa ndihmën e saj.



Zef Prelë Marashi, në bibliotekën “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, me Shoqatën Kulturore “Xhubleta e Alpeve e Shqiptare”, në bashkëpunim me Konsullatën e Austrisë të Nderit në Shkodër, me datën 17 nëntor 2021, në mjediset e bibliotekës “Luigj Gurakuqi” organizoi veprimtarinë në përkujtim të atdhetarit, luftëtarit malësor Zef Prelë Marashi, por edhe promovimin e librit puçlicistik “Malësorë të rritur në Kullat e Gurit” të autorit Gjon Frani Ivezaj.

Një pjesëmarrje e mirë, me figura të letërsisë, historisë, artit dhe të fushave të tjera nga qyteti i Shkodrës, Dukagjini, Malësia e Madhe në të dy anet e kufirit administrativ. Mori pjesë dhe deputetja e Shkodrës, zonja Emilia Koliqi.

Fjalën e hapjes të kësaj veprimtarie e bëri zonja e shtëpisë, drejtoresha e bibliotekës, Valbona Berdica, e cila pasi beri preantimin e veprimtarisë, ja dha fjalën zotit Engjell Ndoci.

Engjelli foli për rendësinë e dokumentarit dhe punën e madhe të profesor Gjon Frani Ivezaj, kushtuar këtij dokumentari, me titull “Ta duash... dhe të shkruash për vendlindjen”, nëpërmjet të cilit doli më në dukje figura e atdhetarit Zef Prele Marashit.

Pas dokumentarit, fjalën e mori krytarja e Shoqatës kulturore “Xhubleta e Alpeve Shiptare”, zonja Rita Shkurtaj, e cila foli për rendësinë e nderimit të figurave të Malësisë, nëpërmjet të cilave ndjehemi me krenar për prejardhjen tonë, por nderojmë vetën tonë dhe u lemë të shkruar brazave të ardhshëm historinë.

Pastaj rapsodi Pretash Nilaj, përshëndeti të pranishmit, duke kënduar një këngë me lahutë tipike malësore, pjese nga Lahuta e Malesise, të at’ Gjergji Fishtës.

Pastaj u prezantua libri me titull “Malësorë të rritur në Kullat e Gurit”, me autor prof. Gjon Frani Ivezaj, nga kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, z. Ndue Sanaj, i cili në fund te fjalës se tij, në emer te Kryesise se Shoqates, I dorezoi zotit Gjon, titullin “Mirenjohja Mehmet Shpendi” dhene atdhetarit e luftetarit Zef Prele Marshi.

Në fund pjesëmarrësit i ka përshëndetur edhe autori i librit, Gjon Frani Ivezaj, i cili mjaft i emocionuar ka folur rreth kësaj veprimtarie kushtuar atdhetarit Zef Prelë Marashit, por edhe për librin e tij.

Në mbyllje të kësaj veprimtarie, në monitor u dha kënga, me titull “Mejdanxhia i Grudës t’Madhe”, e cila ishte kënduar nga këngëtari i njohur Nike Çarku, me banim në Miçigan të SHBA.

SHKUNDJA NGA DREMITJET E PËRGJUMURA TË KULLAVE TË MALËSISË SË MADHE, KU JANË RRITUR BURRAT E GRATË E SAJ

Mendime mbi librin me titull “Malësorë të rritur në kullat e gurit”,
të autorit profesor Gjon Frani Ivezaj -



Librin me titull “Malësorë të rritur në kullat e gurit”, të autorit Profesor Gjon Frani Ivezaj, u ndjeva mirë, kur ma dhuroi autori dhe më ngarkoi, që të bëj prezantimin e tij.

Profesor Gjoni del paranësh me këtë punë të veçantë letraro-historike, pas librit të pestë me vlera historiko-atdhetare, me titull “Iliro-paganet dhe sfidat e Krishterimit në Shqipëri”, i cili para pak kohe u prezantua në bibliotekën e qytetit të Shkodrës “Marin Barleti”, para një auditori të shkëlqyer të qytetit.

E lexova me shumë vëmendje dhe pastaj u ula të shkruaj opinionin tim dhe për rrjedhojë mund të them:

Autori ka pasur mirë parasysh kërkesën, që para se të mësoje të shkruaj, ka mësuar të mendojë dhe t’i thotë vetes,

se çfarë duhet të paraqes në këtë libër, që ti shërbejë lexuesit, ti shërbejë brezave të ardhshëm dhe mendoj, se këtë e ka paraqite mjaft denjësisht.

Me këtë libër autori ka bërë një përpjekje të guximshme, për të na sjellë në kohën e sotme, të gjallë siç thekson Prof. dr. Alfons Cekaj, - duke shkundur nga dremitjet e përgjumur për gati një shekull kullat e Malësisë së Madhe ku janë rritur burrat e gratë e Saj.


Kjo paraqitje nuk është thjeshtë një kureshtje nëpërmjet të një publicistike nëpërmjet artikujve të shkëputur në pamje të pare, por të gjitha së bashke bëjnë një histori më vete, që radhe kush deri tani është përpjekur të na i paraqit me kaq vërtetësi e sikur kane ndodhur dje.

Mjaft domethënëse është artikulli, me titull “Në palcë të gurit asht lidhe Besa”

dhe nëpërmjet saj na sjellë traditën e malësorit në shekuj, që dhe pse i kishte vlarë vëllain, vrasësi kur i kërkoj Besë, Pllumb Marash Pllumbit, ai i dha besën dhe nuk lejoi kënd ta cenojë. Populli këtë akt e ka ngritur në këngë, që në mes të tjerave, në disa vargje theksohet: “*Dy malsor pa pik burrnje / vllazen gjaku, por smir zi / në maraz t’asaj pashie / i zune prit një djali t’ri ...*”

N ‘besën tane Prel Marash Pllumi / me mbro sonte t’kam rixhanë / ...”

Apo neper këngën “Në luftë Koplikut po prinë Gruda” jep të gjalle kodin atdhetar të malësorit të rrite në ato kulla të gurit dhe ja disa vargje të kësaj kënge: “*Mbi krena t’ armikut po i vegon shpata / njeti Zef Prele Marshit me duart e gjate / me*



shtatin e nalt, hijen si mal i ranë / sa dhe shkjaut prej frike, ikën i kish dhanë ...”

Apo nëpër këngën “Zef Prele Marashit, trimit të peiqve t’ Grudës”, që tregon mbi jetën e atdhetarinë e këtij luftëtarit të pa epur... ja disa vargje: “*At’ her Zef Prela trim si zana / që ma trim nuk ban ma nana / n’ daç për besë n’ daç për trimni / shoqi i tij s’ len ma n’ Shqipni ...*”

Me mjaft shqetësim autori, paraqet jo vetëm ndjenjat e veta autori, por dhe të shqiptareve në te dy anet e kufirit administrativ, që në Konferencën e Londrës u more vendimi për copëtimin e Shqipërisë në pesë shtete, nëpërmjet artikullit “Heronj nderkufitar”. Të gjithë këtë shqetësim pa bërë analiza diplomatike e historike e tregon qarte nëpërmjet tragjedisë së Age Zefit, e cila u martua në vitin 1945, kur malësoret dhe pse ishte kufiri, lëvizjen e kishin të lirë dhe më vonë në mënyrë tejet absurde u mbyll kufiri dhe jo pak shqiptar lanë jetën në këtë kufi...

Me artikullin “Misionari At’ Gjergji Fishta, miku i bukës dhe i nderit të malësoreve”, tregon madhësinë Gjergji Fishtës. Ai ishte mjaft i lidhur me malësoret, në zbatimin e kodit të traditës në jetën e malësorit ... Këtë lidhje mjaft qartë e tregon nëpërmjet zgjidhjes së një konflikti dhe ndalet mos derdhjen e gjakut në mes dy familjeve malësore, dhe rolin e punës së mençur të Zef Prele Marashit në interpretimin e kodit të së drejtës dokësore të malësorit mbi bazën e të cilit dhe pse i pa shkruar, por shumë i njohur dhe i zbatueshëm, ishte ai kod që malësoret e maleve kishin ndërtoar gjithçka mbi bazën e tij në shekuj me radhe ...

Apo nëpërmjet artikullit “Humanizmi dhe bujaria e Zef Prele Marashit ka çua peshë vlerësimin e bejlerëve të Shkodrës ndaj malësoreve”, që në mes të tjerave shkruan: “Ishin pikërisht ato vite, kur tregtarët e Shkodrës merrnin udhë me karvanë për të shfrytëzuar nevojat e tregjeve të Tuzit dhe të Pejës ... Në këto kushte në një nga dimrat

Profesot Gjon Frani Ivezaj, nga SHBA, dërgon këtë falenderim mbi veprimtarinë e zhvilluar kushtuar punës së tij, me titull:

BIRO “MANETIN NUK E TRET AS TOKA”, ISHTE POROSIA E FUNDIT E BABËS, PËR TA ÇUA NË VËND NDERIN E GJYSHIT TIM ZEF PREL MARASHI

Qysh në vogëli u rrita me frymën e punëve të shekullit n'prehen t'gjyshave, e n'prag të oxhakut rreth votrës së moçme, në t'bekuemen tokë të Peiqëve, atje në Grudë të Malësisë së Madhe.

Kujdesi e mësimet që mora në vitet e fëmijërisë time të hershme kanë pasur dhe kanë peshën ma t'madhe ndër të gjitha vitet e studimeve të mia akademike historike, filozofike e deri ato ekonomike këtu në Amerikë, pasi ato janë dhe mbeten ekuilibri i qëndrimit dhe gjithë krenarisë time shpirtnore.

Nga vij, ku shkoj dhe se kujt duhet ti ngjaj.

Kjo peshë vlerash e skalitur në memorjen time ishin dhe mbeten përjetësisht si një amanet për ta nderuar dhe dëshmuar para gjithë botës se Kulla e **Mejdanhxisë** së Prele Marash Pllumit, ka lindë dhe rritë vetëm luftëtarë trima, të cilët siç thonë malsorët “kur janë thirrë ata në luftë shpija e Zef Prel Marashit, ose janë kthye me faqe t'bardhë e fitimtarë, ose janë kthye të vdekun në viq, se as plagët si kanë rrëzua kurrë”. Janë pikërisht fjalët e t'vjetërve ato që ma kanë mbajtur të gjallë ëndrrën për ta çuar në vënd edhe amanetin e gjakut dhe vlerave të tyre në sytë e këtij shekulli të ri, i cili gjithnjë e ma shumë po pluhuros me fallsitet historinë e lavdishme të trimave malsor për interesa të dritëshkurtëve patriot të rrejshëm, të cilët lavdinë e blejnë me para e historinë e fallsifikojnë

për tua veshur si këmishën e huaj malsorëve që as emër nuk lanë. Ishte pikërisht ky fallsitet që më shtyu të shkruaj e të dëshmoj vetë për t'parët e mi edhe pse kjo detyrë u takonte të tjerëve ta thonë, pa pasur nevojë ti blej gërmat e bojës së tyre e ti pajtoj si mercenar, kur gjaku i t'parëve të mi la lavdi të përjetshme në malsi. Ky ishte edhe qëllimi i gjithë asaj veprimtarie përkujtimor kushtuar gjyshit tim Zef Prel



Marashi, për të cilin falenderoj me zemër organizatorët e shumtë që banë të mujtun këtë organizim sa zyrtar aq dhe shkencor,

ndër ta Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, Shoqatën Kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, Konsullin “E Nderit” të Austrisë në Shkodër, Bibliotekën e Universitetit “Luigj Gurakuqi” si dhe grupin e Radio Televizionit Shqiptar, të cilët për më shumë se një orë program arritën të bien në sytë e medjave dhe të pranishmëve, dëshmi dhe fakte që pluhuri i harresës nuk do mundet ti mohojë, as sot e as

kagjini” e në veçanti z. Ndue Sanaj, për dhënjën e titullit ma t'naltë të trimërisë “Mehmet Shpendi” me motivacionin: “Për heroizmin e treguar në Kryengritjen e Malësisë së Madhe dhe sidomos në betejat kundër ushtrisë turke dhe serbo - malazeze në vitet 1907, 1909 në Kështjellën “Rozafa” të Shkodrës, dhe në vitet 1910 dhe 1911 në kështjellën e Deçiçit, në të cilat mori katër plagë të rënda. Heroizëm ky i vlerësuar asokohe nga Komiteti i Luftës për Liri me dekorata motivuar për kontribute të veçanta”.

Po kështu dua të falenderoj dhe t'u shpreh mirnjohje të veçanta znj. Rita Shkurtaj, e cila u kujdes për materialet muzeale, të cilat risollën në kujtesë detaje me vlerë për jetën dhe veprën e Zef Prele Marashit, ndër to edhe flamuri model i ngritur mbi Kështjellën e Deçiçit, me 6 prill 1911, për të cilin qe vorrue dy herë edhe gjyshi im. Po kështu dua tu shpreh mirnjohje pjesmarrësve emër për emër e sidomos bashkëvllazënve të mi që erdhën nga Malësia e Tuzi, për tu ba pjesë e këtij evenimenti dinjitoz që më banë, dhe u ndjenë krenar. Nderimi dhe respekti janë duart me të cilat ja lajmë faqen malsisë e ja kujtojmë punët trimërisë ndaj sot që shkruaj nga Amerika e largët ndihem sikur gjyshit tim Zef Prele Marashit ju la gjaku i kujtesës e babës ju përmbush amaneti i dekës.

Profesor Gjon Frani Ivezaj

◀ e acartë të asaj kohe, ishin nisur nga qyteti i Shkodrës me mallra tregu të ngarkuar mbi kuaj dhe mushq shtate tregtarët shkodrane ... Në ato kushte bore e të ftohte askush nuk ju kishte afruar ndihmë ... Një burrë shtate larte, i cili po kthehej nga Podgorica, ju thotë “Mbrëmja e mire burra... - nga ju kemi miq? U sjell kutinë e duhanit, të cilët nga gjendja e renduar fizike, as në duar se mbanin dot prej të dridhurave, ndaj detyrohet tua mbështjell vetë ... Duke i pare ashtu në atë gjendje dhe të pashprese se mund ta shtynin edhe këtë nate ashtu përjashta Zef Prele Marashi, pasi u prezantohet i afron të dalin në kullën e tij në Grudë edhe pse e dinte se në shpi nuk kishte as një grusht miell ...”. Mbas disa kohe ... Zefi e merr viçin dhe ulë në Shkodër tek Dugajet e Reja ..., ku rastis që aty afër të jete kundruall tij njeri nga të shtat tregtarët, i cili i afrohet dhe e pyet për emër: - a je ti Zef Prele Marashi i Grudës? Po i përgjigjet Zefi, pa i dhanë ransi se kush po e pyet. Sa e ke vicin? ... Aty për aty të shtat tregtarët banjë plan me shpërblye secili me nga një ngarkesë kali e me ja çua në shpi pa e dite ai ...

Po kështu, secili artikull, si ai “Si u mbijetoi stuhive kulla mesjetare e Leke Mark Gjebes së Traboinit”, “Kulla e Mirash Gjelit”, “Kulla e Mark Sokolit të Dedajve të Shkrelit”, “Gjergj Mark Kalaj: larg Malësisë i tretun, por në shpirt i etur për vendlindjen dhe bashkëvllaznit e tij shqiptar”, “Humanizmi për shqiptarët është burim patriotizmi që u rrjedh nder deje” apo ligjëratat e mbajtura “Në manifestimin tradicional Kushtrimi i Gjeçovit” mblidhen bashke “Fe e Atdhe”, që të gjitha flasin në thelb për traditat kryesore të malsorëve për atdhetarizëm, për besë, për bujari e për mikpritje, të cilat i majtën gjallë, ju dhanë shpresë e asnjëherë nuk u dorëzuan pavarësisht kushtet e vështira të jetesës e luftës për pavarësi e liri, duke pru parënësh kohët e vështira të atyre shekujve, por të lavdishme, për të cilat dhe brezat do ta ndjejnë veten gjithnjë krenar. Por mbi të gjitha ajo që të tërheq vëmendjen nga autori është zbatuar një thënie e madhe e Gorkit, i cili para një shekulli theksonte: “Të flasësh dhe të shkruash të vërtetën është arti më i rendë nga të gjitha artet ...”, pavarësisht, nëse autori e ka ditur apo

jo. Kjo është e rëndësishme për gjithë ata që shkruajnë.

Profesori, me këtë promovim libri të veçantë, na dha mundësinë, që me shoqatën “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, në bashkëpunim me Konsullatën Austrisë të Nderit në Shkodër, jo vetëm të organizojmë këtë promovim, por dhe Kryesia e SHAD, të futet në punë, për të vlerësuar atdhetarin e luftëtarin Zef Prele Marashin!

Kush ishte Zef Prele Marashi?

Atdhetari e luftëtarin Zef Prel Marashit lindi në vitin 1888, në Kshevë të Grudës, i cili në moshën 17 vjeçare rroku armët kundër pushtuesve turq dhe atyre serbo - malazez.

Në vitin 1907 dhe në vitin 1909 u përfshi në betejat anti turke ku dhe mori dy plagë lufte në kështjellën “Rozafa” të Shkodrës dhe u dekorua për trimëri të pashoqe nga Komiteti i Luftës në Shkodër, në vitin 1909. Në vitet 1910, 1911, mori pjesë në Kryengritjen e Malësisë së Madhe, i cili në të dy betejat mori edhe dy plagë të tjera mbi kështjellën e Deçiçit, për të cilat po atë vit u dekorua nga Komiteti i Luftës në Podgoricë. Në vitin 1920 dhe në vitin 1921 mori pjesë në

Qëndresën e Madhe të njohur si “Lufta e Koplikut”. Ka vdekur në vitin 1971.

Me propozim të Shoqatës kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” ta nderoj me titullin “Mirënjohja Mehmet Shpendi”, Nderi i Kombit, me motivacion:

“Për heroizmin e treguar në Kryengritjen e Malësisë së Madhe dhe sidomos në betejat kundër ushtrisë turke dhe serbo - malazeze në vitet 1907, 1909 në Kështjellën “Rozafa” të Shkodrës, dhe në vitet 1910 dhe 1911 në kështjellën e Deçiçit, në të cilat mori katër plagë të rënda. Heroizëm ky i vlerësuar asokohe nga Komiteti i Luftës për Liri me dekorata motivuar për kontribute të veçanta”.

Me këtë rast, në shenjë respekti për punën e profesor Gjon Frani Ivezaj, po i dhuroj librin tim, me titull “Kujtimet e një ushtaraku”, 45 vite jete ushtarake. ...

I nderuar Gjon Ivezaj të urojmë të na bashkoni përsëri e përsëri!

Ndue Sanaj,
Shkodër, më 17 nëntor 2021

XHUBLETA PASAPORTË E IDENTITETIT KULTUROR KOMBËTAR

Mbresa nga simpoziumi shkencor; Shoqata kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” godet përsësi.

Në ambientet e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër u zhvillua simpoziumi kulturor-shkencor i shumë munguar me temë: “Xhubleta pasaportë e identitetit kulturor kombëtar”, organizuar nga Shoqata Kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, i cili u vlerësua si një organizim sa dinjitoz aq edhe institucional deri në përfeksion, që nga impakti i parë e deri në përshëndetjen e fundit, aq sa me plot gojë mund të thuhet se arriti të sfidojë edhe vetë institucionet përkatëse, që nga ato vendore e deri tek ato më të larta shtetërore, të cilat edhe pse ishin të ftuara, ra në sy mungesa e tyre.

Në këtë simpozium morën pjesë, studiues, etnolog, përfaqësues institucionesh dhe dashamirës të kësaj pasurie me vlera unike në botë. Të pranishme ishin edhe mediat lokale e jo vetëm, të cilat e transmetuan veprimtarin për opinionin publik si një arritje dhe sukses i përmasave kombëtare.

Serioziteti i kësaj veprimtarie u reflektua në programin e ngjeshur sa shkencor aq edhe artistik, të përgaditura me një kujdes të veçantë nga kryetarja e Shoqatës Kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” znj. Rita Shkurtaj në bashkëpunim me Drejtoreshën e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, znj. Valbona Bërdica, e cila mbajti edhe fjalën përshëndetëse të shoqëruar me një punë kërkimore rreth xhubletës, me fakte e referenca sa kulturore aq shkencore, të përshtatura për tematikën kuptimplotë mbi këtë pasuri kombëtare.

Në vazhdim për të pranishmit u shfaq dokumentari me të njëjtin titull “Xhubleta pasaportë e identitetit kulturor kombëtar”, i cili përcolli një mesazh mjaft domethënës dhe shumë konkret, si një përgjigje e saktë për të gjitha pikpyetjet pse xhubleta duhet të vlerësohet si pasaportë identiteti kulturor kombëtar.

Të pranishmit i përshëndeti Kryetarja e Shoqatës “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” znj. Rita Shkurtaj, e cila në fjalën e saj tha: “Të nderuar pjesmarrës, të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe përkatsive vendore, të nderuar studiues, etnologë dhe ju dashamirës të xhubletës, mirë se keni ardhur! Në emër të shoqatës kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” dua të falenderoj secilin prej jush këtu të pranishëm, për nderimin dhe vlerësimin e kësaj pasurie të përbashkët kulturore me vlera tejet të mëdha shpirtërore. Gjej rastin t’i shpreh mirënjohje të plotë Universitetit “Luigj Gurakuqi” për mbështetjen dhe veçanarisht Drejtoreshës së Bibliotekës znj. Valbona Bërdica, për bashkëpunimin më shumë se institucional në realizimin e këtij simpoziumi kulturor-shkencor.

“Xhubleta pasaportë e identitetit kulturor kombëtar”. Pse kjo temë?

Siç u pasqyrua edhe nga dokumentari xhubleta në vetvete është identitet për ata që e mbartin. Është vlerë për të gjithë ne që e kemi. Është kulturë dhe obligim që secili prej nesh ta vlerësojmë. Është dinjiteti i të parëve tanë, ndaj ta nderojmë, dhe ta mbrojmë pasi ajo është një detyrë që na përket të gjithëve”.

Qëllimi i këtij simpoziumi ishte jo vetëm vlerësimi fiziko kulturor i xhubletës, por edhe nxitja për një bashkëpunim ndërkrasinor në ruajtjen dhe kultivimin e kësaj veshje tek brezat e rinj, si dhe ndërgjegjësimi institucional si një thirrje emergjente, për të ringjallur

tekniken e të punuarit të kësaj veshje, krijimin e grupeve folklorike, si dhe ndërmarrjen e një sërë veprimtarish artistike me fokus xhubleten, si e vetmja mënyrë për ta mbrojtur këtë veshje nga asimilimi i pa mëshirshëm kulturor, nga ku do të krijohen edhe ura rezistente për nxitjen e turizmit kulturor.

e peshuar me zemrat e pjesëmarrësve të paraqitura në këtë simpozium, një pjesë e të cilave u demonstrua, janë padyshim një shërbim ndaj etnokulturës shqiptare, ku do të përmbledhen në një libër të shkruar, i cili së shpejti do vijë në dorë të lexuesit, si një manual vlerash për xhubleten dhe dukuritë

krahasuese, nëpërmjet të cilave sipas tij identifikohet kjo tipologji xhublete.

Ajo që e bëri akoma më dinjitoz këtë simpozium, ishte gërshetimi i pamjeve filmike në monitor, duke i bërë kumtesat edhe më konkrete nën kujdesin e montazhierit të talentuar Armando Rrustemi, si dhe një program i shkurtër artistik, ku për të pranishmit performoi me lahutë rapsodi malësor Pretash Nilaj këngën: “Lahuta e Malsisë”, e cila mori mjaft duartrokitje.

Me shumë interes u mirprit dhe kumtesa e përfaqësuesit të Komunës së Tuzit dhe Malësisë së Madhe nën Malin e Zi, i ardhur enkas nga Amerika e largët Prof. Gjon Frani Ivezaj, i cili atë dashamirsinë dhe krenarinë e tij si bir i xhubletës e shprehte me një vlerësim dhe respekt maksimal.

Pastaj kumtesa e rradhës ishte ajo e përfaqësuesit të Bashkisë Pukë z. Alban Doçaj, i cili solli në vëmendje vlerat dhe veçoritë e tipologjisë së xhubletës së Pukës të zbrëthyer deri edhe me detaje.

Për të kuptuar peshën dhe karakterin shpirtëror e zakonor të xhubletës, me shumë ndjenjë u recitua nga Fatjona Gjerka, poezia e Hilë Mosit “Hotjanja”. Pastaj programi vazhdoi me një përshëndetje nga përfaqësuesi i Bashkisë Lezhë z. Renaldo Xhani.

Vallja e logut interpretuar nga grupi artistik “Jehona e Kelmemit” ishte edhe përshëndetja që mbushi me entuziazëm dhe kënaqsi të pranishmit, nën interpretimin me çifteli të rapsodit kelmendas z. Pretash Nilaj.

Veprimtaria u mbyll me një koktejl tepër bujar, plot art e shije, të përgatitur nga punishtja “Goja Goditëse” Shkodër, ku u dha mundësi të pranishmëve të shkëmbejnë biseda dhe të pozonin foto me njëri-tjetrin, si kujtime të një dite të paharruar nga kjo veprimtari shkencore.

Përgatitur Ramzan Çekaj,
Nëntor 2021



Ky simpozium ka edhe një tjetër detyrë sa humane aq edhe institucionale, duke filluar nga vetë shoqata, e cila tashmë është e veshur me petkun juridik, e deri tek institucionet më të larta shtetërore, që ta mbrojmë këtë veshje nga cilido që guxon ta tjetërsojë, të abuzojë apo ta shpërfytyroj për përfitime personale originalitetin e saj në opinionin publik. Ne, sot jemi të vetëdijshëm që disponojmë pasuri shpirtërore që bota na e ka zili; si gjuha, flamuri, historia, kultura, ku secila prej tyre është e skalitur mbi xhubleten, ndaj le t'i tregojmë edhe Botës çfarë përfaqëson kjo veshje për ne.

Çdo kumtesë e shkruar me mendje dhe

fiziko shpirtërore të saj.

Në vazhdim kryetarja znj. Rita Shkurtaj, në emër të shoqatës falenderoi të pranishmit, si dhe ata të cilët bashkë financuan për realizimin e këtij simpoziumi, që me dëshirën e tyre mbeten anonim, me urimin “paçin të gjithë bekimin që Nënlokia me xhubletë jepte për bijt e vet”.

Në vijim, në mungesë të përfaqësuesve të Bashkisë Shkodër për të pranishmit iu dha fjala studiuesit Prelë Milani, për të folur për xhubletën pultake që kjo bashki ka në juridiksion. Një kumtesë mjaft e arriret për nga ana shkencore e qartësuar me detaje e të dhëna



XHUBLETA E DYTRAJTËSHME E MALËSISË SË MADHE DHE E DUKAGJINIT

Mbajtur në simpoziun shkencor, me temë: “Xhubleta pasaportë e identitetit kulturor kombëtar”.

Xhubleta është një tip i veçantë veshje për gra e pa shoqe askund tek ndonjë veshje tjetër e kohës së re. Moshë e lashtë, prerja, pamja e jashtëzakonshme, repertori i motiveve të përdorura, nga më interesantët në artin tonë popullor, me një autencitet origjinal, me një sistem harmonik dekorativ në përshtatje të plotë me pjesët përbërëse i japin xhubletës pasaportën kombëtare të kustomografisë sonë etnike. Biografia dhe gjeografia e xhubletës shqiptare është fokusuar nga një larmi e gjerë studimesh të karaktereve të ndryshëm duke filluar që në fillim të shekullit 18-të nga letrari hungarez Daniel Kordinez e K. Takolaç, pasuar prej baronit austriak F. Nopça (Shekulli XIX), M. E. Durham (fillimi i shekullit XX), për të vijuar më tej me autor të tjerë të kohërave të vona si Rr. Zojzi, B. Jubani, A. Gjergji, M. Fontanes, U. Xhemaj, Dr. Agim Bido e të tjerë. “Nopça xhubletën në pikëpamjen kostumologjike e përkufizon si shumë interesante, për arsye se përkon kryekëput me veshjet në formë fundi të njohura nga disa terakota të zbuluara në Klishavec Serbi dhe të disa vazo keramatike në Kretë me gema të shumtë të Mikenës”¹. Përfundimi i Nopçës është se, xhubleta vijon shtegtimin e gjatë mijëvjeçarëve duke mbërritur deri në ditët tona si petku unikal i grave tona alpine. Rrok Zojzi në studimin e tij “Mbi veshjet tradicionale të popullit shqiptar”², mbështetë plotësisht mendimin e Nopçës mbi prejardhjen e xhubletës nga qytetërimi kretomikenas. Këtë mendim e kanë pranuar edhe disa autor të tjerë si Haerland, Garashanin, Kovaçević e të tjerë, Horens Wilke, Evans e të tjerë³.

Verdikt i pa kontestueshëm i studiuesve dhe etnografëve se Xhubleta, se një veshje e tillë është përdorur vetëm nga shqiptarët në zonën e Alpeve shqiptare me dy epiqendra kryesore Malësinë e Madhe dhe Dukagjinin me zgjatime deri në zonën midis Matit dhe Bunës (ku janë vendosur herë pas here malësorë të zbritur nga Malësia e Madhe), për të vijuar tek shqiptarët e Malit të Zi dhe ata të Rugovës, në Rugovës Kosovë. “Ky fokus nxjerrë natyrshëm në ballë të impresionëve gjurmëlënëse dhe hulumtimeve serioze për kulturën materiale alpine dhe kostumin me xhubletë të grave kelmen-dase e dukagjinase. Ky kostum është një ndër monumentet më përfaqësues e më të hershëm të kulturës etnike shqiptare me origjinë afër 4 mijë vjeçare”⁴.

Xhubleta edhe pse për shkak të analogjive që paraqet me disa tipare të qytetërimin kretomikenas, nuk ka dyshim

se ajo ka qenë një veshje që ka jetuar për shekuj në qytetërimin ilir, është integruar në të dhe është përcjellë përmes shekujve deri në ditë tona. Xhubleta është një mozaik i universit alpin e thurur me një teknologji të posaçme brenda ekonomisë shtëpiake. “Ajo përfaqëson një stil të veçantë veshje, që nuk ngjason me ndonjë model të veshjeve të kohërave të reja askund tjetër në Evropën Juglindore”⁵. Xhubleta është fund i shajaktë me ngjyrë të zezë në pala në formë kambane, është



repertori i motiveve interesante me fizionomi shumë origjinale. Ajo përfaqëson një profil të ngrirë me pak përkulje, ujdusur e gjitha në një konfeksion të leshtë me një sistem dekorativ të dendur gajt-nësh të aplikuar në dy tri shtresa, të cilat ja shtojnë peshën dhe trashësinë, duke e bërë që të rrinë si e ngrirë. Përdorimin e thekave të gjata për zbukurim, qoftë tek supet e xhokës, qoftë tek anët e poshtme të përparës formojnë një kompleks karakteristikash arkaikë në ndërthurje harmonike së bashku me kërdhokullat dhe brezin e gjerë që mbulon mesin e gruas malësore.

Xhubleta malësore me formën e sajë që ulet e ngrihet valë-valë është një armë delikate bjeshke, është fisnikëria, është pastërtia shpirtërore, hijeshia, është sensulitetit dhe vallëzimi solemn. Xhubleta është vitaliteti, talenti, pasioni, daltimi, sekreti, filli dhe vetë jeta. Xhubleta është puthja e brenga, loti e prehri, madhështia e ninulla, ngrohtësia e dashuria. Xhubleta është metafora drita ndriçuese e kohërave moçme. Xhubleta është velloja e amazonave shqiptare, historia, dhe pasqyra ku reflektohet fjonga e visareve më të vjetra e më të çmuara të kulturës sonë popullore me pigment madein ilir.

Xhubleta përbehej prej rripash dhe copash shajaku, me një prerje shumë të ndërlikuar dhe donte mjeshtri të madhe në të qepur. “Një xhubletë përmbante 13-

5 -A. Gjergji “Veshjet shqiptare ndër shekuj”, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë 2000, fq. 165

17 rrogzina (riipa), 5 copa përparje nga 7 rrogzina dhe 6 copa të tjera, kraholi 30 copë dhe kërdhokulla nga 7 copë”⁶. Të presësh dhe të qepësh një kostum, prej kaq shumë copash, nuk ishte lehtë, kompletimi i një xhublete donte disa muaj punë intensive. Edhe qëndisja dhe zbukurimi i xhubletës ishte një punë po aq e ndërlikuar sa edhe prerja. Përdorimi i një sasive të konsiderueshme spiku të zi në 5-6 rreshta të ngjeshur, kërkonte shumë durim shkathtësi dhe intuitë të

gabueshme. Xhubleta zakonisht për të qëndruar mirë në trup mbahej me dy rripa shajaku varur tek supet, por nuk përjashtohej lidhja për mesi me një rrip. Pjesën e gjoksit gruaja vishte “grykën” ose një këmishë të shkurtër si bluzë. Xhubleta përbehet nga tri pjesë shtati, prehri dhe shpina. Puna më e vështirë dhe delikate ishte realizimi i shtatit të xhubletës (pjesa e prapme). “Gjerësia e shiritit të spikut dhe tërheqja e tij në të qepur bënte të formohej tuni i xhubletës; i përberë nga dy valëzime kodra e në mes tyre një lug”⁷. Prehri ishte më i thjeshtë dhe bëhej duke qepur tre katër copa zhguni (shajaku) njëra mbi tjetrën. Në vend, kontakti e prehrit me shtatin thureshin dy *anza* që mbulohehim me një shirit spiku jo më pak se 1 cm të gjerë. Ndërsa në bel nga ana e prapme e xhubletës stilohej shpina, një copë zhguni zakonisht në formë drejtkëndëshi, që arrinte deri tek shpatullat e gruas, ndërsa dy rripa mbi supet që vijonin deri përpara gjoksit, shërbenin për ta mbajtur xhubletën varur si kumbonë në trupin e katanës malësore. Stiletet e këtij kostumi tek disa xhubleta e kanë lënë shpinën e ndarë dhe bashkimi i sajë me trupin bëhej nëpërmjet pullave. Ivat (copat) e xhubletës mbulohehin dhe stilohehin zakonisht me kadife të zezë, duke krijuar një mozaik të ndërthurur

6 -A. Gjergji “Veshjet shqiptare ndër shekuj”, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë 2005, fq. 138.

7 - K. Ulqini, Veshjet popullore në malësinë e Shkodrës “Ernografia Shqiptare”, nr. 17, fq.113

në atë mënyrë sa syri nuk zhbirilon të gjejë fillimin as mbarimin e gjithë asaj mase shajaku spiqesh e rruazash, pse jo edhe copa të punuara në filigram, që formonin së bashku xhubletën. Pas qepjes së xhubletës fillonte qëndisja me (ivë rruzash, me tertil (me ivë tertili). Zbukurime që donin shumë kohë e mund, ato fillimisht bëheshin sipas vizatimeve të bëra në letër. Shkalla e zbukurimeve të xhubletës varej edhe nga gjendja ekonomike e mbartës së saj. Ato që kishin me gjendje të mirë ornamente dekorative ishin më të larmishme jo vetëm në trup, por edhe në shpinën e xhubletës qëndisej me fije ari, me rruaza të zeza ose të kombinuara me ngjyra të tjera. Punimi i një xhublete kërkonte minimalisht 3 muaj punë nga një profesioniste e vërtetë

Etnografët, duke pasur parasysh pjesët përbërëse të këtij kostumi kanë bërë klasifikimin në dy tipa xhubletash.

“Xhubleta e Malësisë së Madhe, e cila është shumë e valëzuar e madhe në formë trapezi e zezë, me një shirit të bardhë në fund (Pëstjellaku), brezi i gjerë prej lëkure mbuluar me pulla sermi dhe kërdhokullat prej shajaku e spiku si një brez rreth 20 cm i gjerë i mbërthyer prapa me një kapëse teli dhe së fundi xhamadani me mangë të gjata”⁸, përgjithësisht i zi. Çorapet e shkruara prej leshi me ngjyrë vjollcë ose trëndafili të qepura pas kallmave. Kallmat bëheshin në formën e kallçijeve (të kopsitur në njërin anë), me shajak të zi, me shumë zbukurime dhe qëndistari sipër. Kallmat kombinohehin me shputa me ngjyra. Në kokë mbahej shamia (ruba që lëshohej lirshëm mbi supet. Nuset e reja i mbanin me ngjyra inkandeshente me lule. Ndërsa gratë që ishin në zi dhe përgjithësisht plakat në ballë mbani poshe, palosur si një rrip 4-5 cm të gjerë

Xhubleta e Dukagjinit (Pultit), është si motër e sajë, por më e ngushtë, më pak e valëzuar dhe pak rrogzinë (shiritin e bardhë) në fund si ajo e Malësisë së Madhe. At’ Benardin Palaj shkruante: “Në Malësi të madhe bien në sy xhubleta në trajtë kumbone, ndërsa në Dukagjin trajta e saj është më e përmbledhtë”⁹. Xhubleta e Dukagjinit mban zbukurime me motive të leshta, rruazat e zeza ishin një element i rëndësishëm ornamental. Veshja me xhubletë është shumë e vjetër, që erdhi duke evoluar gjatë viteve për të mbërritur në trajtën që njohim ne sot, trajtë që u formatua në fund të shekullit XIX dhe paraqitet në formë të dy trajtëshme si xhubleta e Malësisë së Madhe dhe Dukagjinit. Pjesa e sipërme e trupit, gjoksi mbulohej nga “grykëza” kraholi një xhokë e shkurtër shajaku pa pala, por me thekë të gjata leshi te supet. Brezi i mesit prej lëkure i zbukuruar me pafta dhe un-

8 - F. E. Përgjigje të pytsorit të veshjeve për fshatin Selcë (Këlmend)

9 -A’t. B. Palaj “Doke e kanu në Dukagjin”, “Hylli i Dritës”, nr. 4.1943, fq. 24

1 - F. Nopça, Albanieen, fq. 215

2 -Rr Zojzi “Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë”, Studime Historike, Tiranë 1965, nr. 4, fq.151.

3 - A. Gjergji “Veshjet shqiptare ndër shekuj”, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë 2005, fq. 166

4 - Dr. A. Bendo Alpet dhe xhubleta e Malësisë “Kultura popullore” nr. 1, 1996, fq. 195.

LEC SHLLAKU ARKITEKTI I TEATRIT PROFESIONAL SHKODRANË DHE ELBASANAS, NË DATËLINDJEN e 100-të

Sot do ishte rrumbullak 100 vjeç fort iu afrua, por nuk e gëzoi këtë datëlindje, që ëndërron çdo frymore me ndërgjegje. Ky kapak shekullare i fillim i vjeshtës së tretë nuk e gjeti këtu. Ai vetëm fizikisht mungon mbasi në kujtesë tonë mbetet si bazile vetmitare. Trembëdhjetë mote kaluan që trupi i Kolec (Lec) Shllakut pushon në hijen e selvive nder Rmaj, në atë tokë të mbjellë me eshtrat e të shumëve të qytetit të shumë kënduar veriperëndimore.

Ka mbi trembëdhjetë vjet që ky burrë fisnik me pamje madhështore i mungon Pjacës shkodrane, i mungon lozhave të Teatër Migjenit, studios së punës me libra dhe mbi të gjitha miqve dhe familjarëve. Prej varrit që ka për shtroje dheun e morëm, e mbuloje djerrin me trëndafila, na flet prej jetës së pasur, për herë në vegime arti. Kujtimet e Lec Shllakut janë jeta dhe historia e epokës artistike që e polli e rriti dhe e lartësoi. Një jetë plot batica e zbatica, dimra të acarte, pranvera të blerta, vera zhuritëse dhe vjeshta ku e blerta pak nga pak fillon të shndërrohet në të verdhe të arte dhe në ngjyrë kafe të pjekur, ku pemët pak nga pak bjerrin gjithë duke shtruar tapeta të artë të vdekjes së bekueme. Kujtimet e Lec

Shllakut janë një mozaik veshur me mantelin fisnik të atdhetarit, xhamadanin e artë të mirësisë, gozhupin e galmë të burrërisë arbërore dhe kostumin ma trendi të epokës post moderne që ja ka harrua emrin djepit të drunjtë të traditës që përkundi me ninulla dashurish të moçme. At Luigji Palaj atdhetar e martir i kishës, At' Gjon Shllaku filozof dhe mësues martir i ndërgjegjes kombëtare, At Benardin Palaj bleta e visareve kombëtare, At Benardin Shllaku arqipeshkv i Dioqezës së Pultit, shqipja martire e lirisë Marie Shllaku, Dom Mark Shllaku fatos i kishës fatose, Avokat Paulin Pali një nga emrat më të shkëlqyer të inteligjencës shkodrane i martirizuar nga diktatura komuniste së bashku me të vëllain, poetin sentimental Gaspar Pali. Kapitani i Madh i Kombëtares shqiptare Lin Shllaku, janë filizat e trungut të Gabet Kuçit atashit të Shllakut nën hijen e të cilëve blerohet dhe filaditet kultura shkodrane, e cila pa trashëgiminë gjenetike të këtij babëloku do të ishte si tenxherja pa kapak. Prelë Shllaku (fotokopje e "Kamanit"), filiz i Logut të Gega-jve mbi nga leni i mrizeve bjeshkatarë sa herë të rrahur nga era dhe ortiqet, po aq here përtërirë gjallëruar në rrënjë e gjethe

e harlisur në kurma e dege vigane.

Kolec (Lec) Prelë Shllaku (1921-2007), xhunjor i vëllezërve Gjon e Luigj aktor, regjisor, shkrimtare studiues, publicist, njeri me aksesore të gjerë kulturor poliglot njohës i disa gjuhëve të huaja, si greqisht, latinisht, italisht, rusisht, serbokroatisht, frëngjisht dhe gjermanisht.

Lecit në moshën 3 vjeçare, i vdiq i ati së bashku me nënën e vet, Pinën, dhe me vëllezërit u rritën në familjen e dajës së vet, Ndoc Temali, rrobaqepës humorist, teatrist i shquar i skenës shkodrane e bejtari në zë parësor i Karnavaleve në qytetin e Shkodrës. Të varfër, por të bardhë si pëllumbat nder dajë aty shpërthyen e morën hov prirjet e Lecit dhe të Gjonit

Gjonin i mesmi dy vjet me vogël se Lecit (helenisti i shquar) filloren e kreu në kolegjin françeskane, ndërsa 7 vjeçaren në shkollën shtetërore tek "Dugajtë e reja". Nga 24 shtatori 1935 deri 9 dhjetor 1945 studioi në Seminarin Papnuer të Jezuiteve, duke bërë edhe vitet e larta të teologjisë dhe filozofisë, ku mësoi greqishten e lashtë, latinishten. lexoi klasikët e antikitetit helen Sofokliun, Eski-lin dhe Euripidin. Filloi të shkruante me pseudonimin Lyricus.

Më 9 dhjetor 1946 pat ra në burg, ishte 23 vjeç dhe u dënua me burgim të përjetshëm (101 vjet), fillimisht si anëtar i grupit të "Bashkimit shqiptar", si përfundim bëri 12 vjet në burgun e Burrelit dhe në batat e Myzeqesë. Në burg u njoh me Peshkop Visarion Xhuvani, me të cilin thelloi njohuritë në greqishten e vjetër, prej të cilës përktheu pjesë nga Bibla-Apostujt dhe Shenjtorët. Pati hasur edhe në një antologji të veprës së Homerit, të cilën e përktheu. Në burg nxuri greqishten e re, spanjishten dhe anglishten. Pas daljes nga burgu i mundimshëm më 1957 ka punuar te ndërmarrja Zukth-Kashta në Shkodër si llogaritar-normist dhe deri në pensionim shqipëroi disa veprave të autorëve grekë, të Virgjilit dhe "Këngët e Rolandit", dhe të një pune të nisur mbi një fjalor latinisht-shqip me rreth 65 mijë fjalë, të cilin vdekja nuk e la ta mbarojë.

Leci hyri i vogël në shkollën e Fret-nore, të mesmen e vijoi në Gjymnazin "Illyricum". Klasën e fundit e maturën, i mori në Gjymnazin "28 Nëntori". Pajisi mendjen dhe fisnikëroi shpirtin me kulturën klasike aksidentale. Lum ai nga kush mori mësim Fishta, At' Gjon Shllakut, Donat Kurtit, Thanas Gegës e të

aza treshe prej bronzi, ku vareshin stolitë e brezit. Brezi ishte rreth 8 cm i gjerë, por më i ngushte se brezi i malësore. Karakteristike janë dy tufa në formë trapezi, njëra më e madhe, prapaniku, rreth 60 cm i gjatë me thekë leshe ngjyrë vjollce si ato që kishte kraholi tek supet e tjera, prapaniku rreth 30 cm i gjatë, që vihej prapa.

Në këmbë gruaja mbathte çorape leshe të zeza dhe nuk përdorte kallçe si në Malësinë e Madhe. Në kokë mbante shaminë të lidhur ngushtë "Ky variant kostumi quhej "veshje pultake"(Pultit) ka ruajtur disa tipare arkaikë, si në pjesët që e përbëjnë, ashtu edhe në dekorimin e tyre. Ai mbahej kryesisht në zonën e Shllakut e të Temalit në një pjesë të rrethit të Pukës deri në Nikaj Mërtur"¹⁰. Në Shalë e në Shosh sidomos gjatë shekullit XX, xhubleta nuk është shoqëruar me prapanik, ka po thuhet ato po të gjerësi si ajo e malësisë. Pjesa e prapme e xhubletës behej me iva (pala) të ngushta të qepura njëra pas tjetrës, prej belit të konik deri tek pjesa fundore e valëzuar, ndërsa përpara ishte më e varfër në dekoracion pasi mbulohej. Forma e saj ngrihet valë-valë me lugje (variacione) herë delikate e herë të theksuara, përdoren kallmat në formën e kalçijëve, pa ndonjë ndryshim nga ato të malësisë dhe kjo ka ndodhë për shkak të marrëdhënieve ekonomike e shoqërore të ndërsjella, që kishin Shala e Shoshi si me Kelmendin dhe Shkrelin ashtu edhe me Nikaj- Mërturin. Në Shalë e në Shosh xhubleta është një kostum miks mes dy varianteve të krahinave të lartpërmen-dura.

"Për mjeshtret malësore "goditja" e vëllimit karakteristik të kabanës ishte një proces i vështirë top sekret,

10 - Fondet Etnografike, Objekti. nr. Inv. 8460

që realizohej përmes bashkimit të 25-30 copave shajaku të prera në forma të ndryshme"¹¹ Lënda e parë është pëlhura e leshtë e shkelur në vegjë, duhej edhe një sasi e konsideruar spiku përthurjen e së cilës ishte përpunuar një teknologji e posaçme¹². Sasia e spikut ishte e konsiderueshme disa dhjetëra metra linearë dhe vendosej kudo që kishte një të qepur. Motivet zbukuruese vendoseshin horizontalisht në hapësira të ngushta. E vetmja copë tekstili me dekoracion që përdorej në këtë kostum vendosej në pjesën qendrore të përparjes, që përfaqësonte një fushë të zezë ose ngjyrë tullë me disa ornamente të thjeshta vibruar me fije të arta, argjendi ose manushaqe. Përparjes mund t'i dekoloheshin edhe rripa të ngushtë cohe të kuqe ose vishnje. Kjo tip xhublete me tilla zbukurime quhej e kuqe dhe mbahej vetëm nga gratë e reja sinonim i potencës së tyre ekzotike (si dielli në zenit), që i dalonte ato nga xhubleta e bardhë me shirita e sensualitetit vajzëror (joshëse si rrezet e para të diellit pranveror) dhe xhubletës së zezë që mbanin gratë e moshuara si prag i muzgut të ashpër e të ftoftë të pleqërisë dimërore. Sot për sot nuk njihen paraqitje figurative të xhubletës përpara shekullit XIX, kemi vetëm një përshkrim të Kordinëzitet të shekullit XVIII. Etnografët duke bërë krahasime e një varg xhubletash të fiksuara në celuloide nga mjeshtri Marubi në çerekun e fundit të shekullit XIX dhe xhubletës së çerek shekullit dytë të shekullit XX e në vijim, kanë arritur në përfundimin, se kjo veshje ka ardhur duke u thjeshtësuar shumë qoftë nga ngjyrat

qoftë nga zbukurimet, aq sa nga kujtimi i largët ka mbetur vetëm emri "xhubletës së kuqe". Kështu që xhubletat mbas Luftës së Parë Botërore, kanë qenë po thuhet krejt të zeza, me zbukurime me rruaza të errëta, çfarë tregon se pushteti dhe rëndësia e saj erdhi duke rënë sa pas Luftës së Dytë Botërore, doli krejtësisht jashtë qarkullimit me përjashtim të riteve ceremoniale, dasma e vdekje ku përdoret si objekt honorik. Ky thjeshtëzim, ky zvogëlim perimetrit kabanë fundore lidhet me jetën ekonomike sociale jo të një trajtëshme në Malësinë e Dukagjinit në raport me Malësinë të Madhe. Në Dukagjin gruaja ishte më aktive në punët fizike, gjendej kudo për krah burrit dhe bënte po thuhet të gjithë punët bujqësore e blegtorale si burrat, tunduese e rendë dhe buruese ka qenë barra e shpinës. Kjo xhublete kaq e rende dhe me gjithë ata aksesore nuk ishte aspak e përshtatshme për gruan dukagjinase dhe e përveshur me shatë, drapër e kosh në shpinë. Gruaja malësore ishte më tepër stanicë dhe bareshe, punonte shumë më pak se gruaja dukagjinase, nuk njihete barre tjetër në shpinë veç bucelës, kishte kohë më shumë t'i kushtohej punës së dorës. Prandaj e ruajtja më të plotë, në përmasa dhe dekoracion xhubletën e sajë, e cila është më fine, më aristokratike, por më pak praktike. Xhubleta jonë mijëra vjeçare është krenaria e kulturës sonë të lashtë, ndoshta nga të vetmet veshje pa as një ndikim oriental e as sllav, është dy varjatëshe (Malësi-Madhe e Dukagjin), shëmbëlltje e Alpeve tona madhështore, simbolikë i kulteve të vjetra pagane të stiluara me zgjuarsia e delikatesë nga dora e artë grave malësore e dukagjinase.

Xhupeta: Një veshje që i përkjet motit të shkuar, e çregjistruar nga kujtesa pop-

ullore, dhe sikur të mos ishte aparati fotografik i Pjeter Marubit, Idermenos dhe (E. Durhami foto e vitit 1908 në Shalë) etnografet nuk do mund të flisni as gjë për të. Duke u mbështetur te këto fotografi, pa e parë me sy origjinalin, po u informuar nga mbartës të këtij kostumi, atë që nuk ka arrite ta bëj dot as Nopça (dallimin e qartë të Xhupetës me Xhubletën) është munduar ta përkufizojë studiuesi Karahman Ulqini, i cili thotë: "Xhupeta është një fund i bërë me dy copa tirkur të bardhë që merrte formën cilindrike. Rreth 1/3 e pjesës së përparme mbushej me spik, kurse prapa shiriti i spikut ngushtohej deri në 10 cm. Në të dy ja anët, ku bashkoheshin me të qepur skajet e trikut, vihej përsipër një shirit i ngushtë spiku. Xhupeta e grave dhe e nuseve të reja kishte rreshtat e spikut të kombinuar me ngjyrat kuq e zi. Xhupeta shtrëngohej për beli me një rrip të brendshëm ose ushkur"¹³. Të dyja këto veshje janë autoktone ashtu siç thekson Etnografi i shquar Rrok Zojzi, i cili i konsideronte si dy proto-tipa të lashtë. Tipi xhupetës është i përhapur në gjithë popullin tonë, kurse ai i xhubletës gjendej vetëm në disa ishuj të vegjël popullsie... Nga origjina e tyre veshja e xhubletës u përkiste popujve të lashtë mesdhetar, që banonin në vendin tonë, kurse ajo xhupetës shtresës së popujve të quajtur trako-ilir"¹⁴

Prele Milani,

studiues, botues e publicist

13 - K. Ulqini, Veshjet popullore në malsinë e Shkodrës. "Etnografia Shqiptare" 17, fq. 107.

14 -Rr. Zojzi, Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë, Stidime Historike, nr. 4, 1965, fq.15.

tjerë, ishin mësimdhënësit e tij. Fishta, Gjeçovi, Benardin Palaj, Marin Sirdani, janë përfaqësuesit më tipik të gjuhës dhe të folmes së maleve ka thënë mjeshtri i madh i letrave shqipe Ernest Koliqi, ndërsa unë pa frikë do të shtoja se Koliqi dhe Camaj janë kampionet më të mëdhenj të folmes më të thekshme që buron nga gjuha e vjetër shqipe. At' Zef Pëllumbi më tepër në publicistikën historike, ndërsa Danjel Gjeçaj e Lec Shllaku në letërsi janë vazhduesit më të denjë letërsisë françeskanë. Mbas disa motesh pas luftës së dytë rrokupujshme kreu shkëlqyeshëm I. L. P. dyvjeçar të Shkodrës, në degën Gjuhë Letërsi, në vitin 1966 kreu edhe studimet e larta universitare në U. T, në fakultetin Gjuhë Letërsi. Emërohet në Teatrin Qendror të Ushtrisë dhe punon dy vjet, prej ku u dërgua si regjisor në "Teatrin Migjeni" ku punon gjithë përkushtim nga viti 1950 -1962. Në vitin 1962, hapi dhe drejtoi teatrin e ri profesionist "Skampa" deri më 1970. Nga viti 1970- 1976, vit kur edhe doli në pension, ka punuar si mësues letërsie në arsimin e mesëm të përgjithshëm në Shkodër. Mban titullin "Artist i Popullit" dhe Qytetarë Nderi i Elbasanit për kontributin e shquar si aktor dhe regjisor i skenës shqiptare dhe Anëtar i Nderit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Në vitin 1952 vuri në skenë, në teatrin "Migjeni" komedinë e Molerit "Koprraci", qeshte një ngjarje të bujshme artistike për kohën. Ai theksoi veçanërisht anët e forta e dramatike të komedisë, përçudjen e karakterit të njeriut nga vesi i koprracisë, sikundër qe trajtimi i figurës së Harpagonit nga aktori Zef Jubani. Kjo shfaqje u përsërit 67 here dhe u ndoq nga mbi 23700 spektator me një mesatare 350 spektator për shfaqje. Tone të zymta tragjike, shoqëruar me ankth që vinte prej rrezikshmërisë që paraqiste Tuç Maku, u vunë re në inskenimin e dramës "Toka jone" e Kole Jakoves, 1954.


Koncepti regjisorial i L. Shllakut i dha një frymë realiste dramës së Ndreku Lucës, "Shtate shaljanet", 1958, duke iu larguar zgjidhjeve monumentale e patetike dhe duke mësuar sa më shumë vërtetësi historike dhe karaktere të gjalla.

E njoha kur isha në hapat e pare të shkrimeve të mia, e desha kur më respektoi dhe më afrooi buzë vetit. E çmova për herë e më tepër, pasi duke u pjekur e kuptova më qartë. E nderova me bindje se në portretin e tij dallova izohipset e një vigani malesh latuar dhe stolisur me kulturën me të shëndoshte qytetare. E pashë se si i ruajti këto okë të shëndetshme burmimi kurë shumë të tjerë i bjerrën nga politika dhe interesa. Sjellja e tij e mirësishtme, njerëzia, fisnikëria dhe thjeshtësia takti me dite me fol me këdo ishin kolonot e karakterit të tij.

Lec për ketë të desha sa ishte gjallë dhe sot të kujtoj me përmallim atje ku gjendesh nder varre. Usta Leci i takon asaj plejade të shkëlqyer profesionistësh, që teatrin foshnjor të Shqipërisë së pas luftës antifashiste e morën për dore e përkëdhelën gjithë dashuri prindërore, e ushqyen, e rritën duke e çuar në majat më të larta të traditës sonë dhe e shndërruan në një tempull të populluar, të dashur për shikuesit të cilët në ketë altar të artit skenik argëtoheshin dhe edukoheshin njëherazi.

Bagazhin e gjer kulturor, zgjuarsinë

talentin i përdori si mjet, por kurrë si tupa për nxjerrë vetën në pah. I qeshur, i shkueshëm, i dashur mikpritës, mësues shembullor, i lindur për prijës në llogoret teatrale prandaj qenë fatlum ata aleat që udhëhoqe ti me pishtarin e ndezur olimpik maratonën e artit. E pra ata ishin emra që bëjnë nderë teatrit tonë kombëtare si Zef Jubani, Pjetër Gjoka, Loro Kovaçi Adem Kastrati, Paulin Laca, Lec Bushati, Ndreku Prela, Tinka Kurti, Marie Logoreci, Vitore Nino, Antoneta Fishta, Paulin Lacaj, Demir Hyskja, Rrobert Ndrenika, Vjollca Gega, Antoneta Kristo, Thoma Kristo, Zhani Shllaku, Beb Shiroka, Viktor Bruçeti, Çesk Vuksaneti e të tjerë e të



tjerë .

Lec Shllaku ishte trau kulmorë i teatrit të ri "Migjeni", ku solli njëra pas tjetres vepra fort të lakmuara nga çdo regjisor si "Koprraci" (Moljer, 1952), "Agimi"(K. Jakova, 1952), "Toka jonë" (K. Jakova, 1954), "Shërbëtori i dy zotnive" (K. Goldon, 1955, "Tartufi" (Moljer 1955), "Shtrengata" (Ostrovski. 1956), "Angjelo tirani i Padovës" (V. Hygo 1957), "Berberi i Seviljes" (Bomarshe, 1957), "Shtatë shaljanët" (N. Luca 1958), "Banorët e shkallës nr. 6" (K. Dushi 1958), "Dy binjakët venecjanë" (K. Goldon, 1959), "Trumbetjerja" (Sallinskij, 1959).

Lec Shllaku qe themeluesi teatrin profesionist "Skampa" të Elbasanit, produkt i regjisë së tij ishin pjesë "Lida" (Xh. Broja, 1964), "I pesti u zu gjallë" (N. Zoraqit 1966), "Udha e largët" (Arbuzov 1966), "Udha e Zavalive" (Th. Borodani 1967), "Firmat e Vogla" (Th. Borodani,

1968), "Skënderbeu" (L. Shllaku, 1968), "Shqetësimet e Sokratit" (L. Shllaku, 1968), "Njeriu që pa vdekjen", ku pas shfaqjes aktori me fame internacionale Viktor Eftimiu në librin e përshtypjeve ka lënë shënimin, "Teatrit profesional rumun i mungojnë aktor të tillë si këta që pashë këtu, që përveç se maestro i arenës teatrale Lec Shllaku ka dhënë kontributin e tij të çmuar edhe në kinematografi duke interpretuar edhe krijuar karaktere të spikatura në filmat "Skënderbeu" (roli i fisnikut Gjon Kastriotit), "Ngadhënjim mbi vdekjen" (roli i oficerit gjerman i ashpër i frikshëm gjakatare), - (1967), "Rruga e lirisë" - (1982), në rolin e malësorit

lindjen dhe rrugën e zhvillimit të skenës shkodrane, "Loro Kovaçi" monografi, botim i plotë për jetën dhe veprën e tij, "Shtegtimi i monumenteve" (studim, "Dy hapa në Perëndim" (përshtypje udhëtime), "Palokë Kurti"-në 145 vjetorin e lindjes (monografi), "Plaka dhe harkoçi miki"(romanth), "Historia e një plage" (roman), Ngatërrim stinësh dhe romanin "Njerëz mes nesh"- që mbeti në dorëshkrim së bashku po thuaj me gjysmën e krijimtarisë së tij më i pjekur si librin katër vëllimesh "Jete pezull", ku tregon se si e pa dhe e njohu ai Shqipërinë.

Lec Shllaku ishte një latues i talentuar gegnishtes gurgulluese që gjallon plot frazeologji burimore. Gegnishtja e Shllakut nuk kufizohet brenda gardhiqeve nëndialektore veriore. Si letrar kishte një stil elegant të matur i thellë, i lidhur nder arsyetime, i armatosur gjer në dhembë dhe depërtues në psikologjinë shoqërore.

Veprat që la pas Lec Shllaku akoma nuk janë bërë objekt studimi e një kritike të mirëfillte profesionale, por ajo duket ballafaqe se ai ishte një njohës i përpiktë i gjuhës lapidare të geqe, rojtare dhe bujk i mirë që dinë me zgjedhë, farën e shëndoshtë, por edhe ta mbjellë në valikën e duhur, duke siguruar mbirjen e një bime të fillikat, të cilën e here e prashitë dhe ujitë me plot dashuri.

Leci ishte dhe ju përkushtua arsimimit e edukimit të brezave me të njëjtin pasion si artit dhe librave. Prind shembullorë "flamurtar" fatlum në krye të një dinastie artistesh. Primos (që mban emrin e Gjyshit Prelë), i dhuroi dhuntinë e të shkruarit, shkrimtare autoritare, studiues, pedagog dhe flamurbajtës i gegnishtes së salvume. Brunos një emër fort i mirënjohur i fali mjeshtrinë e arkëtimin dhe regjisë. Bruno nuk qëndroi duarkryq dhe gjeti një nuse si vetin Paskualinën, njërën prej aktoreve më të talentuara të brezit të saj, sa simpatike aq edhe gjithë sharmë artistik. Mirësinë, thjeshtësinë, ëmbëlsinë, fisnikërinë, bukurinë e zemërbardhësinë u fali vajzave, Rajmonda e Greta, ku pa dyshim adhurimi, debulesa, llastica dhe dashuria superiore ishte Rajmonda.

Kjo familje pati një amë si bleta, bijën fisme të Zef Hillit të Mguilles. Roza ishte Afërdita e artisti Lec Shkallu, i cili thoshte se gjithë jetën kemi nda tri fjalë me njeri tjetrin, *urdhëno, ke të drejtë, më fal* dhe është mbyll çdo kapitull. Zhgënjimin më madh nga Leci e pësoj kur e divorcoi vdekja. Ngarkuar me një barre kujtime bashkëshortore sa Taraboshi nën përkujdesjen e Mondes qëndroi deri në moshën 94 vjeçare, kur u largua nga kjo botë dhe shkoi në amshim atje ku priste dashuria e vetme e jetës së saj. Kështu e njoha unë Lec Shllakun, artist dhe njeri të kapur nga bukuria dhe mirësia e jetës dhe idealet me të epërme njerëzore.

Lec Shllaku kolosi që njezh Shkodra dhe gjithë Shqipëria, ai sot ka ditëlindjen e 100-të, me një kufi të pa ndare mes jetës dhe vdekjes. Ashtu si kështjella shkodrane kujton "Rozafën" mot pas moti, ashtu do kujtohet edhe emri i arkitektit themelues të teatrit profesional në Shkodër dhe Elbasan Lec Shllaku.

Prele Milani,
studiues, botues e publicist

NJË VIT PA ZEF FUSHËN

U mbush një vit që nuk e kemi midis nesh, mikun dhe shokun tonë të rrallë ZEF FUSHËN. Armiku i padukshëm që ka pushtuar botën bëri që të ndërrojë jetë dhe Zoti e mori në gjirin e tij. Ishte korrekt e i përpiktë si askush tjetër për zbatimin e rregullave anti-covid, madje shumë kritik ndaj atyre që neglizhonin në këtë drejtim. Por ja që armiku të godet edhe atje ku nuk e pret.

Kemi një vit që nuk ja dëgjojmë zërin e ngrohtë dhe zilen e telefonit, me të cilin na ftonte për kafe apo na jepte informacione të ndryshme. Nuk ja ndiejmë hapin e tij të vrullshëm trotuareve të qytetit, me atë trupin e tij të drejtë, i cili sfidonte vitet që kishte mbi supë, i veshur bukur si Ai e me shumë shije.

Kemi një vit që nuk e shijojmë humorin e tij të hollë dhe këshillat e mençura që nuk përtonte me ja dhënë kujtdo.

Kemi një vit që nuk e kemi në ballë të tavolinës, në kafën e mëngjesit apo veprimtaritë të ndryshme familjare apo publike, që nuk përjetojmë kënaqësinë e SMS-ve të tij të bukura të shoqëruara me fotografi për veprimtaritë e ditëve më pare dhe për një çast na kap heshtja, mërzia dhe trishtimi. Por shpejt e marrim veten, sepse si pas një perdeje magjike na shfaqet imazhi i tij i gjallë dhe i hijshëm, vital e plot energji, ashtu krenar e i palodhur, nga i cili kemi ç' të kujtojmë dhe të mirat e tij na qetësojnë.

Në ditën që Zefi ndërroj jetë, edhe unë isha në një kapërcyell midis jetës dhe vdekjes, ku fatmirësisht qëndrova në anën e parë. Pata një mërzi dhe një dhimbje të madhe për humbjen e tij, dhe mërzia u shtua edhe më shumë, sepse nuk munda t'i jepja lamtumirën e fundit për në përjetësi. Prandaj ndjeva një detyrim moral e shoqërorë për ta paraqitë sa më të plotë figurën e Zef Fushës, si njohës i mirë i tij. Do të ndalem në momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së tij. U lind në vitin 1945, në një familje me tradita patriotike, e cila mori pjesë aktive në të gjitha momentet historike apo që koha i diktoj dhe shquhej për mikpritje, bujari e bukëdhënë, gjithmonë derën e hapur për mikun, rrugëtarin, fukananë apo të huajnë.

Mbaroj shkollën 7 vjeçare në vendlindje, në vitin 1959 dhe në vitin 1964 përfundoj shkollën e mesme pedagogjike "Shejnazë Juka", me rezultate shumë të mira.

Me përfundimin e shkollës së mesme filloj me entuziazëm punën e vështirë, por të nderuar e fisnike të mësuesit. Nga një politikë e mbrapsht kuadri në vitet e diktaturës, gjeografia e shkollave ku Zefi ka dhënë mësim, ka qenë shumë e gjerë, duke e lëvizur nga një shkollë në tjetrën.

E filloj punën si mësues fillimisht në fshatin Lekaj, pastaj dy vjet në Toplanën e largët në vitet 1966-67. Kthehet në Gimaj, ku krahas punës si mësime dhënë shquhej edhe në veprimtaritë sportive.

Mbas shërbimit ushtarak 1967-69 e rifillon punën si mësues në Breglumë, disa vite në Abat dhe përsëri pak kohë në Gimaj. Krahas mësimeve, nuk pushonte së studiuar për të shtuar njohuritë shkencore e profesionale, për t'u bërë më i aftë

e më i denjë për kryerjen e detyrave që i ngarkoheshin kudo ku shërbeu, në veçanti arsimimin e dukagjinasve. Si rezultat i këtij përkushtimi, në vitin 1976 përfundoj studimet në universitetin e Tiranës, pa shkëputje nga puna, midis vështirësive të panumërta. Se sa studiues dhe i etur për dije ka qenë e tregon biblioteka shumë e pasur me libra që ka lënë pas.



Mbas përfundimit të shkollës së lartë, shërben për shtatë vite drejtor shkolle në Ndrejaj-Shosh, i cili është më gjurmëlënësi në anën pozitive të fjalës, ku shquhej për aftësitë drejtuese, i dashur e komunikues me vartës e prind, por edhe i papajtuashëm me mangësitë e vërejtura. Ishte model në bashkëpunimin me pushtetin vendor dhe instancat arsimore nga i cili kanë se çfarë të mësojnë edhe sot drejtuesit e shkollave. Me të njëjtin përkushtim e vazhdoj punën edhe në Abat të Shalës, në detyrën e drejtorit të shkollës, në vitet 1983-88.

Karrierën në fushën e arsimit e mbylli në shkollën e mesme të bashkuar Breglumë-Shalë, në detyrën e drejtorit të asaj shkolle. Në periudhën që kjo shkollë është drejtuar nga Zefi ka qenë në pararojë të shkollave si motra jo vetëm të zonave malore, por edhe më gjerë në të gjithë procesin mësimor-edukativ. Në të gjitha shkollat që ka punuar e drejtuar ka qenë vetë i pari në krye të punëve, duke dhënë shembullin personal, shumë kërkuar ndaj vetës e të tjerëve duke pasur gjithmonë arritje të larta.

Tek Zefi kanë qenë të gërshetuara vetitë dhe virtytet më të mira të trashëguara nga familja dhe mjedisi ku u rrit, me edukatën qytetare bashkëkohore e përvetësuar në bankat e shkollës e sidomos në shkollën e jetës. Ka qenë gjithmonë shumë bashkëkohor, ka përkrah ndër të parët të renë, progresisten dhe bënte diferencën në veshje, në mënyrën e të jetuarit dhe si partizan i ndryshimit. Kurrë nuk bashkëpunoj me të keqen e negativën, por ishte shumë kritik ndaj anëve negative që vërente te të tjerët dhe asnjëherë konformist.

I mirëpriti ndryshimet demokratike të viteve pas nëntëdhjetës, mori pjesë aktive në jetën politike duke u pozicionuar përkrah atyre që ishin për ndryshimin dhe ishte shumë herë kritik për mënyrën e ndryshimit, duke çuar gjithçka në zero.

Mbas një eksperiencë katër vjeçare si kryetar i pushtetit vendor në fshatin Nica – Shalë, duke i ditur aftësitë e tij drejtuese dhe formimin e përgjithshmen, në vitin 1997 u emërua sekretar i këshillit të rrethit Shkodër, detyrë që e kreu me devotshmëri për katër vite. Pastaj, për shumë vite ka qenë kryetar i komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave për qarkun e Shkodrës. Edhe detyrat jashtë sektorit të arsimit i ka kryer me ndërgjegje të lartë duke qenë shumë korrekt e autoritar në punë, shumë kërkuar, me një aftësi të admirueshme komunikimi me njerëzit, i papajtuashëm me të metat e mangësitë e vërejtura dhe çdo shfaqje korruptive, për të cilin flasin fjalët më të mira edhe sot njerëzit që kanë pas kontakt dhe kanë kërkuar ndihmesën e Zefit. Ka qenë shumë objektiv në analizën e jetës politike e shoqërore, duke qenë shumë kritik ndaj fenomeneve e dukurive që bien ndesh me zhvillimin e demokracisë. Ka shpreh gjithnjë indinjatën e tij për shumë plagë të hapura që nëpërkëmbin dinjitetin e popullit tonë sidomos të bashkëvendlindasve të Tij. Ishte për shtetin ligjor, larg mendësive të vjetra kanunore si dhe ishte për integrimin sa më të shpejtë të dukagjinasve në jetën urbane, duke dhënë vetë shembullin personal, sepse Ai kishte shumë vlera qytetarie.

ZEF FUSHA ka qenë një prind

e bashkëshort shembullor. Model në mirëkuptimin dhe harmonizimin e punëve në çift, tolerant, por edhe shumë kërkuar. Bashkë me bashkëshorten, Katrinë lindën, rritën dhe edukuan tre djem të mrekullueshëm: Fatmirin, Leonardin e Dritanin, te cilët sot ata janë familjar shumë të mirë, korrekt e të përkushtuar kudo ku punojnë, shëmbëlltyrë e prindërve të tyre. Ata janë krenar për babën e tyre, i cili ju la fjalën e mirë, një emër të mirë e me prestigj, shokë e miq të shumtë, të cilët gjithmonë do t' i kenë në krah. Duhet të punojnë tërë jetën për ta lartësuar emrin e tij, duke e pasur burim frymëzimi në punën e sjelljen e tyre.

Që në formimin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Zefi ka qenë ndër anëtarët e parë të saj, aktivist i mirë dhe papërtësë ka ofruar ndihmesën e tij edhe për gazetën "Dukagjini". Bij të tillë i bëjnë nderë Dukagjinit, që ia ngrenë akoma më lart emrin me sjelljen dhe veprën e tyre. Prandaj edhe Zefit i jemi mirënjohës, për gjithçka ka bërë për zhvillimin dhe konsolidimin e arsimit në Dukagjin dhe për forcimin e shtetit ligjor. Kishim akoma nevojë për Të, për punën dhe këshillat e tij shumë të vlefshme.

I shtrenjti Zef! O miku e shoku ynë më i mirë! Të mori shpejt opozita e jetës, vdekja ogurzezë. Ti na mungon jo nga zemra e mendja, por vetëm fizikisht. Ti jeton në kujtesën e njerëzve të tu të zemrës, të shokëve e miqve të tu të shumtë, me të cilët ke punuar, mësuar e jetuar, ku për ta ke kenë model. Do të jeni i paharruar midis bashkëkohësve të tu, të cilët i deshe dhe të deshën shumë.


I PËRJETSHËM QOFTË KUJTIMI JOT! PUSHOFSH NË PAQË!

Përgatiti **Prelë SHYTANI**

PËR TY, SHPIRTI MË DHEMB

Tronditja për mua
e datës tridhjetë nëntor,
Ishte një shpellë
e ngrirë në krahëror
Sa te vështirë e pata
Ngushëllimit t'i bëj pritë,
Sepse ti për mua ishe
Llambushkë plot me dritë
E sjell nder men, e sjell
Urtësinë tënde proverbiale
Kujtoj fëmijërinë e largët
Kur të ndoqa si dele manare
Edhe pse s'të kam afër
këshillat e tua dëgjoj,
Mbyll sytë e me shfaqesh
Xhaxha pas teje vrapoj.

Diana Çelepia, Poete



U nda nga jeta Mjeshtri Fadil Kraja, Anëtari i Nderit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”

U nda nga jetë, në moshën 90-vjeçare shkrimtari e dramaturgu i shquar shqiptar, “Kalorësi i urdhërit së Skenderbeut”, “Mjeshtri i Madh”, “Krenaria e Qytetit” dhe Anëtari i Nderit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, profesor Fadil Kraja.

Homazhet për këtë figurë të shquar u zhvilluan, me datë 19, nga ora 9-12, në hollin e teatrit “Migjeni”.

Kraja u lind në Shkodër, Shqipëri, më 1931. Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin e Shkodrës ku spikati me talentin për letërsinë. Studimet e larta i përfundoi në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Filologjisë, dega Gjuhe-Letersi. Pas diplomimit punoi ne profesionin e mesuesit te cilin e trashegonte edhe nga familja e tij.

Në vitin 1950, filloi punën për herë të parë si mësues në fshatin Mjedë. Në atë kohë nuk kishte shkollë në këtë fshat keshu qe mesimi zhvillohej në shtëpinë e njerit prej banoreve, Hasan Metit. Kjo shkollë kishte 50 nxënës të ardhur nga 8 fshatra: Shelqet, Spathar, Laç, Qyrsaq, Hajmel, Ganjoll, Kaç, Naraç, dhe 4 mësues; Isak Ramadani, Fadil Kraja, Rifat

Barbullushi, Gita Shani.

Fadil Kraja kontribuoi për vite me radhë si një mësues i nderuar në fshat e qytet duke nxjerrë nga duart e tij nxënës e studentë që u shquan me pas në fusha të ndryshme, në veçanti në letërsi dhe art.

Fadil Kraja luajti rol të madh edhe në gjallërimin e Gjimnazit të Shkodrës si mesues i letersise. Më vonë ai punoi si pedagog i letërsisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi” – Shkodër. Për disa kohë drejtoi Klubin e Rinisë dhe më vonë ishte anëtar i përhershëm i Këshillit Artistik në Teatrin “Migjeni”.

Nga viti 1972 gjer më 1992 ka qenë shkrimtar në profesion të lirë, duke vijuar si pedagog i jashtëm në fakultet dhe njëkohësisht Kryetar i Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve për Degën e Shkodrës.

Fillimet e para në krijimtari datojnë në moshë të re. Vëllimi i parë poetik “Kënga ime” (1954) fitoi çmimin e parë në Konkursin Kombëtar të Letërsisë.

Vëllimet poetike:
Kënga ime

Melodi malësore
Jehona malesh

Vëllime me tregime:
Kandidatja e fundit
Ndodhitë e Nereidës
Fajin e kishte Besa

Romane:
Britma e një gruaje
Pengu i diellit
Balada e nënës

Drama: Ka shkruar mbi 50 drama dhe komedi të suksesshme e të shfaqura në të gjithë teatrot profesioniste të Shqipërisë, si dhe në Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni dhe në diasporë.

Mes tyre përmenden:
Fisheku në pajë, i cili vetëm në Shkodër u shfaq rreth 500 herë.

Sinjalet e natës
Shpartallimi
Baca i Gjetajve
Gjaku i Arbërit
Djem të mbarë
Çështja e Blertës

Flamur në dasëm
Rozafa
Kur flasin zemrat
Luani i shtëpisë
Çështje familjare
Njerëz të ditëve tona
Mos më shkim hisen e diellit
Jorgani
Ditari i një mësuesi
Dopio gjashta
Dy jetë
Midis dy dhimbjeve
Surpriza

Martesë me internet
Nata e fundit, si dhe shumë drama për fëmijë, skenare filmash, librete operash dhe operetash.

Me themelimin e Shoqates Atdhetare “Dukagjini”, i është dhene titulli “Anetar Nderi i Shoqates Atdhetare Dukagjini”, që me 20 dhjetor 2005

Lamtumirë mjeshtër i madh!
I paharruar kujtimi i juaj!

Ndue Sanaj, Gjergj Leqejza, Prele Milani, Agron Hasanaj, Prele Shytani, Ndue Mici e Gjon Kosteri



NË GJURMËT E PREND BUZHALËS

NJË PROFIL I BEGATË DHE CILËSOR JETËSHKRIMI E VEPRIMTARIE

- Me rastin e 70-vjetorit të lindjes së shkrimtarit e Anëtarit të Nderit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" -

Prend Buzhala u lind më 1 nëntor 1951 në Çabiq të Klinës. Filloren e kreu në Ujëmirë, gjimnazin në Klinë, Fakultetin filologjik (gjuhë e letërsi shqipe) në Prishtinë. I ndoqi edhe studimet postdiplomike, po për shkak të burgosjes politike më 1982, ato iu ndërpre në dhunshëm nga regjimi i kohës, ashtu siç iu ndalua edhe botimi i shkrimeve. Botoi shkrime letrare prej vitit 1967. Shkruan poezi, prozë, kritika e studime letrare, publicistikë etj. Gjatë dekadave të fundit të shekullit XX ishte i angazhuar në lëvizjet nacionale, politike e kulturore të kohës, asamblist komunal etj.

1.

Ka punuar profesor i gjuhës e letërsisë shqipe në shkollën e mesme të Klinës në vitet 1976-1982, kur më 26 mars 1982 arrestohet e burgoset vetëm pse nuk u pajua me masat diskriminuese kundër nxënësve e shkollës shqipe, që ndërmerre fushat antishqiptare e regjimit serbo-komunist. Gjatë viteve '80 u ndërmorën një varg masash kundër tij e familjes së tij: pas lirimt nga burg-izolimi, u përjashtua nga procesi arsimor; iu ndaluar kryerja e studimeve post-diplomike; iu ndaluan publikimet në shtypin e kohës, iu ndaluan të qenët prezent si shikues në koncerte, ngjarje sportive e në orë letrare; iu ndalua punësimi në çfarëdo fushe të punësimit; iu ndalua nxjerrja e një pasaporte dhe lëvizja jashtë shtetit. Kundër familjes së tij u morën masa të ngjashme: për shkak se qenkan "fajtorë" që janë pjesë e familjes; dy studentë, motër e vëlla, largohen nga studimet universitare, të cilëve nuk iu lejua as punësimi etj. në vitet '70 e sidomos në ato '80, ishte veprimtar i lëvizjeve ilegale që zhvilloheshin në Kijevë, Klinë e në mbarë Kosovën.

2.

Arsimit iu kthye në vitet 1990-1996, në gjimnazin e Klinës, pastaj drejtues i arsimit komunal të Klinës (1995-1999). Gjatë viteve '90 (përpos veprimtarisë ilegale atdhetare), ka qenë pjesë e kreut të degës së LDK në Klinë. Vlen të theksohet se në komunën e Klinës lëvizja politike e IDK fillimisht e masivisht, u organizuar në Ujëmirë, mars 1990, kur u zgjodh nga 400 pjesëmarrës drejtues i saj, e mandej, prej qershorit 1990, kur u organizua në nivel komunal, ishte edhe anëtar i kryesisë së kësaj dege, ku ka drejtuar disa komisione: për informim, Komisionin për kulturë dhe atë për arsim. Në fillimvitit '90 ka qenë anëtar i Lëvizjes së pajtimit të gjaqeve për komunën e Klinës. Ndërsa atë vit themelohet Forumi i Intelektualëve Shqiptarë "Luigj Gurakuqi" në Klinë, kur u zgjodh kryetar i saj për një dekadë rresht.

Më 1993 ka qenë drejtues i Protestës masive popullore në Klinë, të prindërve, arsimtarëve dhe nxënësve, për kthim në objektet e tyre shkollore, protestë që bëri bujë edhe në botën e jashtme dhe ngjalli interesimin e organizmave ndërkombëtare, për shkak se qenë keqtrajtuar barbarisht mbi 220 qytetarë, ndër ta dhjetëra të arrestuar.

3.


Me shkrime letrare e publicistike është marrë prej vitit 1967 që i ka botuar në "Rilindja" e "Pionieri", "Fjala", "Bota e re", "Zëri i rinisë" etj. të Prishtinës.

Gjatë viteve '90 ka qenë korrespondent i gazetave "Bujku" e "Rilindja" (1993-shkurt

me shumë sakrificë.

4.

Pas luftës vazhdon me veprimtarinë në lëmin e gazetarisë, duke punuar korrespondent i gazetës "Rilindja" dhe duke e kryer po



2002, kur u ndalua së botuari gazeta). Gjatë gjithë kësaj periudhe është arrestuar rreth 40 herë nga policia serbiane, shpesh i keqtrajtuar deri në rrezikim jete, sepse punonte në shumë fronte të të rezistencës e të jetës nacionale në Klinë e më gjerë.

Gjatë luftës ka qenë nëpër zonat e luftës, duke kryer angazhimin e informimit nga zjarret e betejave dhe nga përjetimet e rënda e tragjike të popullatës së strehuar nëpër male e të dëbuar nga vatrën e veta (shkrime të botuara te "Rilindja", raporte për informatorin e QIK-ut, pastaj herë pas here edhe të radiove të jashtme, duke iu raportuar korrespondentëve shqiptarë në Prishtinë, po edhe i asociacioneve tjera mediatike të luftës. Gjatë luftës, po ashtu, është përkujdesur edhe për arsimin edhe në këtë kohë të rëndë Këshilli Komunal i Arsimit u pranua si e ligjshme edhe nga administrata e UÇK-së në zonat e Klinës, të cilët e kanë ndihmuar këtë këshill në kohë të rënda, e

ashtu edhe punën e kritikës letrare në përcjelljen e veprimtarisë botuese, me shkrime kritiko-letrare, deri në mbyllje të gazetës. Punoi ngjashëm edhe te gazetat "Epoka e re" (2003-2008, Radio Rilindja (1999-2002), "Express" i Prishtinës (2005), redaktor i faqeve të kulturës në të përjavshmen "Focus" të Prishtinës, në disa agjenci lajmsh etj. Për këto dy dekada, shkrimet e punimet e tij kritiko-letrare e studimore janë botuar tek të gjitha gazetat e revistat e Kosovës, te disa medie në Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi dhe në ato të diasporës. Ndërkaq, punimet e rregullta javore, përpos te "Rilindja" (1999-2002) i ka botuar te "Epoka e re", te "Kosova sot" (2006-2010 e herë pas here edhe më vonë), te "Focus" etj.

Pas luftës punoi edhe zyrtar arsimi (2001-2003), drejtor biblioteke në qytetin e Klinës (2008-2013), drejtor shkolle në shkollën e mesme të ulët "Dëshmorët e kombit" në vendlindje më 2015-2016 etj. Është redaktor

e recensues i qindra botimeve, bashkëpunëtor e pjesëtar i shumë asociacioneve letrare, fitues i disa çmimeve letrare, organizues e pjesëtar i dhjetëra manifestimeve letrare e kulturore në hapësirat shqiptare. Është prezantuar edhe në disa antologji, në faqet letrare të Zvicrës (gjermanisht) Francës (frëngjisht), është pjesëmarrës në një festival ndërkombëtar të poezisë në Zvicër. Shkrime kritiko-letrare e studime letrare e eseistike ka botuar në shumë gazeta e revista shqipe në Prishtinë, Tiranë e Shkup.

5.

Pjesë e veprimtarisë së gjithanshme kulturore, kanë qenë edhe angazhimet e tij në lëmin e teatrit. Në tetarë ka luajtur si gjimnazist te shfaqja "Sikur t'isha djalë" që u shfaq në Klinë, Prishtinë, Drenas, Skenderaj etj. Si mësimdhënës i shkollës së mesme "Luigj Gurakuqi", paralelet në Kijevë, gjatë viteve '70, si regjisor, ka përgatitur shfaqjet "Halit Gashi" të Xhemil Dodës, dramën "Thyerja" të Abdyl Bunjakut etj. Kurse gjatë viteve '90 me asociacionet klinase organizuan disa herë edhe festivale teatrore në nivel komunal e që mbaheshin nëpër shtëpi e sallone private, po edhe nëpër kisha e xhamia. Kështu, si regjisor, përgatiti dramën "Hamalli" të Osman R. Gashit (me të rinjtë e Çabiqit), dramën "Procesi" të Jusuf Gërvallës (nga dy grupet amatore, të Bubavecit të Malishevës dhe të Çabiqit të Klinës), recitalin dramatik "Dymijë vjet derdhje gjaku" (me të rinjtë e Çabiqit) dhe recitalin me krijime të Gjergj Fuishtëls nga nxënësit e shkollës së mesme "Luigj Gurakuqi" - punkti në Ujëmirë.

6.

Vlen të theksohet se është themelues i disa grupeve letrare e revistave lokale. Kështu, më 1967 në shkollën fillore (aso kohe) "Zenel Hajdini", themeloi Grupin e letrarëve të rinj, pastaj në gjimnazin "Luigj Gurakuqi" në Klinë, Grupin letrar "Jeronim de Rada", me disa krijues të rinj gjimnazistë; ishte në grupin themelues te Klubit letrar "Jehona e Dukagjinit" dhe i revistës për letërsi e kulturë "Jehona e Dukagjinit" (1970, Klinë). Në gjimnaz ishte iniciator i themelimit të revistës për gjimnazistë me titullin "Ylli" (1969); pastaj themelues i revistës po ashtu shkollore "Synimet" 1977 (Grupi Letrar "Fan S. Noli"), si mësimdhënës në gjimnazin "Luigj Gurakuqi" të Klinës- paralelet e ndara në Kijevë. Më 1991 ishte ndër themeluesit e gazetës së parë të pavarur që u botua si gazetë jashtë traditës komuniste, me titullin "Bashkimi", së bashku me disa ish të burgosur politikë. Gjatë vitit 1990/91 ka qenë edhe në Këshillin redaktues të gazetës "Fjala" (Prishtinë). Ndërkaq, gjatë viteve '90, për disa vjet, botoi revistën "Tribuna", organi i Forumit të Intelektualëve Shqiptarë "Luigj Gurakuqi" të Klinës, si dhe revistën "Profili", organ i Këshillit Komunal të Arsimit në Klinë. Pas luftës ka qenë edhe anëtar në redaksinë e revistës "Zoja e Këshillit të Mirë" (organ i Kishës katolike - Klinë), disa numra të paraluftës i gazetës "Fjala e lirë" (organ i PSHDK-së) etj. po ashtu, për shumë dekada, ka qenë dhjetëra

herë anëtar e drejtues jurie në nmivel lokal e kombëtar për vlerësim veprash, krijimesh letrare. Ndërsa punën e lektorit e ka kryer te disa gazeta, si dhe te qindra libra të botuar.

7.

Është edhe fitues çmimesh letrare. Kështu, çmimi i parë është ai i vitit 1967 te gazeta "Rilindja" ("Rilindja për fëmijë") me temë "Pse e dua librin", si dhe një tjetër çmim i parë është ai i vitit 1970, te qendra komunale e rinisë në Klinë, me poezinë kushtuar Luigj Gurakuqit. Më 1983 fiton çmimin për kritikë letrare te gazeta "Bota e re" me punimin kushtuar veprës së Ramiz Kelmendit "Njerëzit dhe kërmijtë". Ndër dhjetëra çmime të tjera do veçuar këto të pasluftës, si Çmimin letrar "Anton Pashku" nga Takimet e Gjeçovit të Zymit, atë të LNPSHA PEGAS (Tiranë) për kritikë e studime letrare, disa çmime të para e të dyta të fituara në Takimet e Dom Mikel Tarabulluzit në Stubëll, çmimin e "Pena e Flakës" (Flaka e Janarit) për poezi në Gjilan, çmimin Ora e Tahir Deskut për letërsi (në Klinë), çmimin e Klubit ABC (Shkup), disa çmime letrare "Takimet nën Rrap" nga Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptarë të Maqedonisë në Shkup etj.

8.

Pas luftës ka qenë dy herë i zgjedhur asamblist i Asamblesë Komonale të Klinës. Prej vitit 2016 është në pension.

VEPRAT E AUTORIT

I. Poezi

*O Amë, o Amë, Klubi letrar "Vorea Ujko", Klinë, 1995.
 *Për kë bie kabanë e re, "Vorea Ujko", Klinë, 1998.
 *Shtatë seanca pranë Apokalipsit, "Vorea Ujko", Klinë, 1998.
 *Këpucët e rënda të lirisë, 2010, botimi II, 2012.
 *Çaste lirike (1-90), vëllimi i parë, 2014.
 *Çaste lirike II (91-181), 2014.
 *Doracak për kapërcimin e udhës së vështirë, 2017.
 *Dy udhë me i marrë me veti, 2017. Botimi II, 2018.
 *Kumtari ynë përpara Gjergj Kastriotit, poezi, 2018.
 *Fletëza poetike për njerëz të thjeshtë, poezi, Lena, Prishtinë 2019.
 *Thuaj ditë e mirë është sot, kryeradhë vargësh (poezi), Rozafa, Prishtinë 2020.
 *Ani i ilirishteve, poezi, Lena, Prishtinë, 2020.
 *Muri yt i mundimeve, poezi, Lena, Prishtinë, 2021.
 *Koha zero pas dashurisë, poezi, Lena, 2021

II. Kritika, studime, studime monografike, vështrime

*Metafora e vendlindjes, 1999. Botimi II 2012.
 *Përfaqje estetike, 2000.
 *Ex libris - I, 2003.
 *Odeoni i fjalës, 2003.
 *Shkrimtari pranë buzëqeshjes. Studim për letërsinë për fëmijë të Ali Huruglicës,

2005. Bot. II 2012.

*Muza e zemrës, 2006. Botimi II 2012.
 *Temë dhe tekst, 2006.
 *Muza e Kujtesës, 2007. Botimi II 2012.
 *Aty ku krizat i besohen engjëllit, (Ndërkommunikime estetike: arti - literatura -lufta), 2008. Botimi II 2012.
 *Res Publica e shkrimtarit, (Ese, trajtesa), 2008,
 *Botimi II 2012,
 *Kode poetike të mbijetesës shpirtërore/ Mbi romanet për të rritur të Anton N. Berishës, Argeta LMG, Tiranë, 2009.
 *Gjenitivi i lirikës (Poezia e Mirko Gashit), studim monografik, 2009.
 *Të folurit e kryqëzimit shqip/ poezia e sotme shqipe, 2011.
 *Amëza e rrëfimit - Shkrime kritikoletrare / proza e sotme shqipe, "Rozafa", Prishtinë 2012.
 *Dëshmia për plagën e ftohtë, /libri dokumentar, shkrime metakritike, ese, 2012.
 *Klasiku modern i tekstit -Letërsia e Ramiz Kelmendit (studim monografik), 2013. Botimi II, 2014.
 *Në mbrojtje të imagjinatës (Nga letërsia shqipe për fëmijë), 2014.
 *Gjakimi i bukurisë/ Letërsia e Ramadan Mehmetit, 2014.
 *Me sibilën e esesë (ese letrare), 2015.
 *Muza e dhjetë, ese, 2015.
 *Trilogji e letrave shqipe (Autorë dhe vepra: përfaqje historiko-letrare), 2015.
 *Triumfi në anën e shkrimtarit (Ismail Kadare në një triptik: letrarësia, dskursivja, receptimi), 2016.
 *Harpa e Eolit (Gjon Gjergjaj: letërsia, arti, kultura), 2016.
 *Shtegtime me magjinë e së bukurës (Ismet Krasniqi: kultura, teatri, librat), 2016.
 *Në aktin e leximit I (Nga poezia e sotme shqipe: vepra dhe autorë), 2016.
 *Në aktin e leximit II (Nga proza e sotme shqipe: vepra dhe autorë), 2016.
 *Në aktin e leximit III (Nga libri i sotëm shqip: autorë dhe vepra), 2016.
 *Në aktin e leximit IV (Nga libri i sotëm shqip: autorë dhe vepra), 2016
 *Në aktin e leximit V, (Nga libri i sotëm shqip: poezia, drama, proza, libri diskurziv), 2016.
 *Gojëtaria, mbretëresha e fjalës së shqiptuar (Ese, trajtesa, studime. Antologji e teksteve të fjalimeve nga gojëtaria shqiptare). Vëllimi i parë, 2017.
 *Katarza e ripërtëritjes, ese, 2017.
 *Në aktin e leximit, VI, 2017.
 *Në aktin e leximit, VII, 2017.
 *Në aktin e leximit, VIII, 2018.
 *Në herodiumin modern (pesëdhjetë ese), 2018.
 *Shenja figurative e amësisë (Idriz Berisha: arti, kultura), Prishtinë, 2018.
 *Kosova pas luftës së katërt botërore (Vjaskat e moteve, ese, këndshikime vëllimi I), 2018.
 *Vjaskat e moteve (ese, këndshikime), vëllimi II, 2018.
 *Sfidat estetike të letërsisë për fëmijë (Nga letërsia e sotme shqipe për fëmijë), 2018.
 *Gjergj Kastrioti - Skënderbeu: arketipi i heroit nëpër kohë, (Ese, studime, këndvësh-

trime), 2018.

*Krijuesi në tejkohë (NË AKTIN E LEXIMIT, Vëllimi IX, homazhe, shkrime kritike, interpretime), 2018.
 *Në aktin e leximit, X, 2019.
 *Shqiptimi i shpirtit poetik (Ese mbi lirikën). Vëllimi i parë. 2019.
 *Poetika e letrës së gjakut (Fjala e shkruar e Rasim Selmanajt), studim monografik, 2019.
 *Në aktin e leximit, XI, 2019.
 *Në aktin e leximit, XII, 2019.
 *Në aktin e leximit, XIII, 2020.
 *Në aktin e leximit, XIV, 2020.
 *E drejta e mendjes (ese, trajtesa), 2020.
 *Shën Jeronimi dhe bota ilire (vëllimi I nga seria "Shën Jeronimi, figurë e madhe botërore"), monografi, 2020
 *Në aktin e leximit, XV, 2020
 *Dekameroni zbret në kohën tonë, Ese e trajtesa në kohë pandemie, 2021
 *Në epokën e dyshimit, ese, trajtesa, 2021
 *Gjeopoetika e krijuesit letrar (Fjala e shkruar e Mikel Gojanit), Lena, Prishtinë, 2021
 *Në aktin e leximit, XVI, 2021.
 *Në aktin e leximit, XVII, 2021.
 *Shqiptimi i shpirtit poetik, vëllimi i dytë. Ese dhe interpretime të poezive lirike. Lena, Prishtinë 2021
 *Shenja të etnisë, Vëllimi I. (Kumtesa, ese nga manifestimi DITA E PLISIT në tetë edicione), Rozafa, prishtinë 2021. III. **Romane, tregime**
 *Moisiu fluturonte me Qerren e Zjarrtë, roman, 2003.
 *Tregime të shenjta, Shkup, 2014, Botimi II, Prishtinë 2014.
 *Sinapsa e heshtjes (Tregime me pak fjalë). 2016.
 *Heroi i rrugës (Tregime me pak fjalë), 2017.
 *Njerëzit prej fijeve të dritës, roman, 2019.
 *Shejzat e kryqëzimit, (Tregime me pak fjalë), 2020.
 *Sizifi pa gurin e tij (Tregime me pak fjalë), 2020
 *Në kapërcyell, roman, 2020
 *Zërat jashtë vetvetes (Tregime me pak fjalë), 2021
IV Publicistikë historike dhe kulturore
 *Lartësimi i lirisë. Monografi për mësuësin dëshmor Ismet Rrahmani, 2002.
 *Ata hynë vetë në këngë (vëllimi i parë), kushtuar
 *Dëshmorët Mujë Krasniqi, Beqir Gashi e Ali Krasniqi në festivalin "I këndojmë lirisë", 2015.
 *Prend Buzhala dhe Mikel Gojani: Fryma dhe rezistenca tereziane e humanizmit (Nga veprimtaria e SHHBK "Nëna Tereze" në Klinë 1990 - 2000), 2016.
 *Pjetër Gjoni në shtigjet jetësore e tereziane (Veprimtaria e Shoqatës Humanitare Bamiëse "Nëna tereze" në Zvicër), Lena, Prishtinë 2021.
V. Përgatiti për shtyp
 *Tekstament letrar, Mendimi kritik për veprën e Ramadan Mehmetit, me komente, Prishtinë 2008.
 *Të kuvendosh nën shenjën e Euterpës, Intervista të Akil Mark Kocit dhënë medieve 1976-

2008.

*Prishtinë 2009.
 *Kurorë lirike, përzgjedhje nga poezia e poetëve të komunës së Deçanit, FOCUS, Prishtinë 2012.
 *Dita e plisit vëllimi I (bashkautor Ismet Krasniqi), - Kumtesa, kronika, reportazhe, poezi, komente, 2014.
 *Dita e plisit vëllimi II (bashkautor Ismet Krasniqi), - Kumtesa, kronika, reportazhe, poezi, komente, 2015.
 *Dita e plisit, vëllimi III (bashkautor Ismet Krasniqi), - Kumtesa, kronika, reportazhe, poezi, komente, 2017.
 *Dita e plisit IV, (bashkautor Ismet Krasniqi), - Kumtesa, kronika, reportazhe, poezi, komente, 2018.
 *Krijuesi i fjalës së zemrës (Qasje veprave letrare të Mërgim Osmanit nga autorë shqiptarë dhe të huaj). Përgatiti, Prend BUZHALLA. Botues Lena Graphic Design 2019.
 *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe epoka jonë, (Klina në Vitin e Gjergj Kastriotit). Përgatiti: Prend Buzhala, Forumi i Intelektualëve "Luigj Gurakuqi", Klinë 2019.
 *Dita e plisit V, (bashkautor Ismet Krasniqi), - Kumtesa, kronika, reportazhe, poezi, komente, 2019.
 *Hijerina e artit (shkrime të autorëve të ndryshëm për Idriz Berishën si piktor e poet), 2020.
 *Dita e plisit VI, (bashkautor Ismet Krasniqi), - Kumtesa, kronika, reportazhe, poezi, komente, 2020.
 *Rrëfime nga izolimi (Tregime, ese, kronika, refleksione). Përgatiti me komente Prend Buzhala. Prishtinë 2020.
 *Ismeti Krasniqi në përmasën e receptimit lexues e vlerësues, Punime nga autorë shqiptarë për librat e Ismet Krasniqit, recensione, mbresa dhe opinione. Përgatiti: Prend Buzhala)
 *Dita e plisit VII, (bashkautor Ismet Krasniqi), - Kumtesa, kronika, reportazhe, poezi, komente, 2021.
 *Ringjallja e memories poetike, Qasje krijimtarisë letrare të Ramadan Mehmetit me punime nga autorë shqiptarë e të huaj, Rozafa, Prishtinë 2021. Përgatiti për shtyp : Prend Buzhala.
VI. Nga të tjerët
 1. Psherëtimë pergamene (zgjedhje)- zgjedhje dhe parathënien e shkroi: Anton Nikë Berisha, 2017
 2. "Fluturim me karrocë të zjarrtë" / ,Flug mit der Feuerkutsche - Flight with the Carriage" - libër tregjuhësh: shqip. Gjermanisht, anglisht.
 (Fragment i romanit "Mosiu fluturonte me Qerren e Zjarrtë", roman, 2003, RILINDJA, Prishtinë - e autorit Prend Buzhala, përktheu gjermanisht: Bardhec Berisha). Me tekste nga Lea Brun, Katharina Thalman, Lili Vanilly, dhe Bujar Berisha (përthyer në anglisht: Adi Blum). Botoi Verlag Die Diebe, Luzern. 2019.
 3. Mikel Gojani: SHTRESIME LETRARE DHE STUDIMORE TË PREND BUZHALLËS, Prishtinë 2021

Përgatiti Mikel Gojani

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI
 Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:

SHAN STAKA
 KALIFORNI, SHBA

